

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE



TEZË MASTERI

Përdorimi i metodave efektive nga mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe

Mentori: Prof. Dr. Naser Pajaziti

Kandidatja: Elona Bytyqi

Prishtinë, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT
PROGRAMI MASTER: MËSIMDHËNIE NË GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE



TEZË MASTERI

Përdorimi i metodave efektive nga mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe

Mentori: Prof. Dr. Naser Pajaziti

Kandidatja: Elona Bytyqi

Prishtinë, 2022

© [2021 Elona Bytyqi] Të gjitha të drejtat e rezervuara.

“Përdorimi i metodave efektive nga mësuesit e gjuhës dhe letërsisë shqipe”

NGA

Elona BYTYQI

Paraqitur në:

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit

Departamenti: Mësimdhënie në gjuhë dhe letërsi shqipe

Në përmbushje të pjeshme të kërkesave për gradën Master i mësimit të gjuhës dhe letërsisë shqipe

Mentori: Prof. Dr. Naser PAJAZITI

Prishtinë, 2022

© [2021 Elona Bytyqi] All rights reserved.

"The use of effective methods by teachers of Albanian language and literature"

By

Elona BYTYQI

Submitted to:

University of Pristina, Faculty of Education

Department of: Teaching Albanian language and literature

In partial fulfilment of the requirements for the degree of Master of Teaching Albanian language and literature

Supervisor: Prof. Dr. Naser PAJAZITI

Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	vii
ABSTRACT	x
DEKLARATA E VËRTETËSISË	xii
FALËNDERIM	xiii
KAPITULLI I	14
HYRJA	14
KAPITULLI II	18
SHQYRTIMI I LITERATURËS	18
Metodat dhe llojet e tyre	20
Roli i përdorimit të metodave efektive në të nxënit e nxënësve	22
Aplikimi i metodave në lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe	23
Benefitet nga përdorimi i metodave në mësimdhënie	25
Pengesat në përdorimin e metodave efektive	26
Përdorimi i metodave efektive në kurrikulë	27
Përdorimi i metodave efektive gjatë pandemisë	29
KAPITULLI II	30
PYETJE E HULUMTIMIT	30
PYETJE NDIHMËSE HULUMTUESE:	30
HIPOTEZA	30
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	31
Mostra	31
Instrumentet	36
Procedurat	36
KAPITULLI IV	37
Analiza e të dhënave dhe rezultatet	37
KAPITULLI V Diskutimi	62
Konkludimet	64
Kufizimet e hulumtimit	65
Hulumtimet në të ardhmen	65

Implikimet praktike nga hulumtimi.....	66
REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE	Error! Bookmark not defined.

Lista e tabelave

Tabela 1: Karakteristikat përshkruese të mostrës, gjinia dhe vendbanimi i tyre

Lista e figurave

Figura 1: Zhvillimi i aktiviteteve në klasë, përdorimi i metodave efektive (Burimi: Shkolla fillore e mesme e ulët “Gjon Serreçi” Ferizaj)

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Lokacioni i shkollës ku japin mësim mësimdhënësit e anketuar

Grafiku 2: Gjinia e mësimdhënësve të anketuar

Grafiku 3: Moshë e mësimdhënësve të anketuar

Grafiku 4: Përgatitja profesionale e mësimdhënësve

Grafiku 5: Krahasimi i përdorimit të metodave efektive në shkollat rurale në krahasim me shkollat urbane

Grafiku 6: Ndërlidhja mes moshës së mësimdhënësit dhe përdorimit të metodave efektive

Grafiku 7: Korrelacioni mes moshës së mësimdhënësit dhe përdorimit të metodave efektive

Grafiku 8: Përvoja e mësimdhënësve të fushën e edukimit

Grafiku 9: Ndërlidhja mes përvojës së mësimdhënësit dhe përdorimit të metodave efektive

Grafiku 10: Numri nxënësve në klasë

Grafiku 11: Sa e aplikojnë mësimdhënësit përdorimin e metodave efektive

Grafiku 12: Sa orë mësimore mësimdhënësit i'a kushtojnë metodave efektive

Grafiku 13: Çka përdorin mësimdhënësit për planifikimin e një ore me metoda efektive

Grafiku 14: Niveli i vështirësisë së planifikimit të orëve me metoda efektive

Grafiku 15: Niveli i ndikimit pozitiv të të nxënësve me metoda efektive

Grafiku 16: Nxitësi më i madhë për realizimin e orëve me metoda efektive

Grafiku 17: Niveli i rëndësisë së përdorimit të metodave efektive në zhvillimin personal dhe akademik të nxënësve

Grafiku 18: Mendimet e mësimeve në rëndësinë e përdorimit të metodave efektive si pjesë e mësimit

Grafiku 19: Mendimet e mësimeve në kthimin e orëve me metoda si obligative

Grafiku 20: Pohimet e mësimeve në ofrimin e udhëzimeve nga kurrikula e Kosovës për zhvillimin e orëve me metoda

Grafiku 21: Mendimet e mësimeve për financimin e orëve nga DKA ose Ministria e Arsimit

Grafiku 22: Mendimet e mësimeve rreth preferencës së tyre për përdorimin e metodave efektive

Grafiku 23: Përfitimet e nxënësve nga mësime me metoda efektive

Grafiku 24: Mendimet e mësimeve në ndikimin e pandemisë në mbajtjen e orëve mësimore

Grafiku 25: Niveli i përdorimit të teknologjisë nga mësuesit për mbajtjen e orëve mësimore

Grafiku 26: Ndërlidhja mes vendndodhjes së shkollës dhe përdorimit të teknologjisë

Grafiku 27: Pengesat kryesore që shfaqen në mbajtjen e orëve mësimore me metoda efektive

Grafiku 28: Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësuesit për mbajtjen e orëve me metoda

Grafiku 29: Gatishmëria e mësimeve në pjesëmarrje në trajnime

Lista e akronimeve

CGFS – Udhëzuesi Kurrikularë për Fazën Themelore (angl. Curriculum Guidance for the Foundation Stage)

QCA – Autoriteti i Kualifikimeve dhe Kurrikulave (angl. The Qualifications and Curriculum Authority)

COVID-19 – Sëmundja e Korona Virusit të ri 2019 (angl. Coronavirus Disease 2019)

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

MASHT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

ABSTRAKT

Mësimdhënia është veprimtari e organizuar që ka për qëllim zotërimin e përmbajtjeve mësimore, përvetësimin e njohurive, aftësimin e nxënësve. Sic e dimë, mësimdhënia më e mirë është ajo gjatë së cilës përmbushen objektivat, nxitet ndërveprimi, nxënësi është në qendër të mësimdhënies, nxënësi punon në mënyrë të pavarur etj. Për ta realizuar në mënyrë efektive mësimdhënien mund të përdorim metoda të ndryshme dhe atraktive, të cilat ndihmojnë jo vetëm që të tërheqin vëmendjen e nxënësve, por edhe t'i mbajnë mend apo t'i përvetësojnë përmbajtjet mësimore, përdorimi i metodave efektive ndihmon në nxitjen e nxënësve, në zhvillimin e mendimit kritik e krijues. Por megjithatë problemi qëndron se nuk përdoren këto metoda në shumicën e rasteve në shkollat tona, sepse kemi ende mësimdhënës që preferojnë të zhvillojnë orën mësimore në mënyrë tradicionale - me mësimdhënësin në qendër.

Ky hulumtim ka për qëllim që të determinojë se: Sa prej mësimdhënësve përdorin metoda efektive në lëndën e gjuhës dhe letërsisë shqipe në komunën e Ferizajt?

Hipoteza e këtij studimi është se: Mësimdhënësit e Gjuhës dhe letërsisë shqipe nuk përdorin metoda efektive në realizimin e orës mësimore. Hulumtimi u zhvillua përmes metodës sasiore ku si teknikë e studimit është përdorur pyetsori i mbyllur. Mostër në hulumtim kanë qenë 60 mësimdhënës të shkollave të mesme të ulta të komunës së Ferizajt, të cilët kanë shprehur qëndrimet e tyre rreth përdorimit të metodave efektive, përparsitë dhe vështirësitë që i hasin gjatë përdorimit të këtyre metodave. Rezultatet e nxjerra nga hulumtimi tregojnë që mjaftueshëm mësimdhënës përdorin metoda efektive në mësimdhënie, gjithashtu mësimdhënësit e shkollave urbane dhe që janë më të rinjë në moshë dukshëm përdorin më shumë metoda efektive se sa mësimdhënësit që janë më të moshuar.

Fjalët kyçe: Gjuhë dhe letërsi shqipe, mësimdhënie, metodë, të nxënit.

ABSTRACT

Teaching is an organized activity that aims to master the learning content, acquisition of knowledge, training of students. As we know, the best teaching is the one during which the objectives are met, interaction is encouraged, the student is at the center of teaching, the student works independently, etc. To effectively teach, we can use different and attractive methods, which help not only to attract the attention of students, but also to remember or assimilate the learning content. The use of effective methods helps to motivate students, to develop critical and creative thinking. However, the problem is that these methods are not used in most cases in our schools, because we still have teachers who prefer to conduct the lesson in a traditional way - with the teacher at the center -.

This research aims to determine that: How many of the teachers use effective methods in the subject of Albanian language and literature in the municipality of Ferizaj?

The hypothesis of this study is that: Teachers of Albanian language and literature do not use effective methods in the realization of the lesson. The research was conducted through a quantitative method where the closed questionnaire was used as a study technique. The sample of the research were 60 lower secondary school teachers in the municipality of Ferizaj, who expressed their views on the use of effective methods, the advantages and difficulties encountered during the use of these methods. The results of the research show that enough teachers use effective teaching methods, as well as urban school younger teachers are apparently using more effective methods than their older and rural school colleagues.

Keywords: Albanian language and literature, teaching, method, learning.

DEDIKIM

Kjo tezë masteri i dedikohet familjes sime, në veçanti prindërve të mi, për mbështetjen dhe besimin e ofruar gjatë gjithë rrugëtimit tim akademik dhe jetësorë.

DEKLARATA E VËRTETËSISË

Unë, Elona Bytyqi, studente e nivelit master në Fakultetin e Edukimit, programi “Masteri i mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe“, deklaroj se kjo tezë masteri është punimi im origjinal. E gjithë literatura dhe burimet tjera që i kam shfrytëzuar janë të listuara në referenca dhe të cituara në mënyrë korrekte, gjithashtu shpërndarja, mbledhja dhe analizimi i të dhënave është në përputhje me kodin etik për mbrojtjen e konfidencialitetit të individëve pjesëmarrës në hulumtim.

DEKLARUESJA:

NËNSHKRIMI:

Elona Bytyqi

Data:

FALËNDERIM

Falënderime të veçanta do doja të shprehja për mentorin tim, njëkohësisht udhëheqësin e këtij punimi, Prof. Asoc. Dr. Naser Pajaziti, ku eksperiencia, përvoja dhe profesionalizmi i tij më kanë shoqëruar gjatë gjithë kohës së hartimit të punimit.

Falënderoj edhe familjen time, për ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme që më kanë dhënë gjatë rrugëtimit tim akademik.

KAPITULLI I

HYRJA

“Qëllimi kryesor i arsimit është të krijojë njerëz që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjesht të përsërisin ato që kanë bërë brezat e tjerë-njerëz që janë krijuar, shpikës dhe zbulues. Qëllimi i dytë i arsimit është të formojë mendje, që mund të jenë kritike, që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë çdo gjë që u jepet”-Piaget (Piaget)

Kjo thënie e Piaget përbën sot detyrën parësore të shkollës.

Mësimdhënia i ngjan një udhëtimi të vështirë e plot të papritura dhe është proces i orientuar dhe i qëllimshëm për realizimin e të cilës përdoren metoda dhe strategji të ndryshme që e lehtësojnë dhe e bëjnë më efektive mësimdhënien. Metodatat kanë rëndësi të vecantë në teorinë dhe praktikën mësimore, sepse ato përcjellin ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor, këto metoda apo strategji ndihmojnë në tërheqjen e vëmendjes së nxënësve në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore e në zhvillimin e mendimit kritik e krijues.

Thomas Eliot ka thënë se nuk ka asgjë të përhershme, përveç ndryshimit. Në fakt, ato që po e karakterizojnë sot, botën dhe njerëzimin janë ndryshimet e shpejta, si: zhvillimi i teknologjisë, kërkesat e reja në tregun e punës, marrëdhëniet në shoqëri, aspiratat njerëzore në shekullin e ri etj. Pa dyshim që këtyre ndryshimeve, arsimit duhet t’u përgjigjet me ritme të shpejta e cilësore.

Një listë e metodave për mësimdhënie do të përfshinte shumë ide, shembuj dhe diskutime të cilat janë thelbësore për një mësimdhënie efektive. Zgjedhja e metodave ka rëndësi shumë të madhe, sepse ato duhet t’u ndihmojnë nxënësve në kuptimin e përmbajtjes në mënyrë sa më të lehtë dhe efektive.

Preferencat pedagogjike të mësimdhënësit për përdorimin ose mospërdorimin e metodave atraktive në mësimdhënie më kanë motivuar të kryej këtë hulumtim me qëllim që të kuptohet sesa i përdorin metodat atraktive mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulëta në komunën e Ferizajt.

Me përdorimin e metodave të ndryshme mësimdhënësit ndjehen të përtrirë në profesion dhe e zhvillojnë mësimin me kënaqësi, sepse nxënësit janë më të ciluruar, diskutojnë më shumë dhe punojnë me dëshirë.Me përdorimin e metodave të ndryshme janë krijuar përvoja pozitive të cilat bazohen në Taksonominë e Blumit, në modelin Hunter, në modelin e të nxënësve me këmbime, të stileve të të nxënësve, të mësimdhënies për zhvillimin e inteligjencave të shumëfishta, modelin e zgjidhjes së problemit, etj.

Parimet e përgjithshme që duhet të përdoren në zhvillimin e planeve mësimore janë:

- 1.Planet të hartohen në mënyrë të tillë që të paqyrojnë synime të caktuara të të nxënësve të nxënësve në lidhje me sferën njohëse, emocionale apo të zhvillimitfizik të nxënësve.
- 2.Objektivat mësimore të jenë të qarta dhe të arritshme për nxënësit.

- 3. Veprimtaritë mësimore të jenë në përputhje me arritjen e objektivave mësimore apo të standardeve dhe të ndikojnë në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësve.
- 4. Veprimtaritë e vlerësimit të jenë koherente me objektivat dhe veprimtaritë mësimore.

Mësimdhënia i ngjan një udhëtimi të vështirë e plot të papritura, misioni i saj sot është të kontribuojë në formimin e shprehive të të menduarit të nxënësve. Metodot dobiprurëse, të efektshme të mësimdhënies, të përdorura në klasë, i përfshijnë nxënësit në një llojshmëri të gjerë praktikash ndërvepruese. Metodot e mësimdhënies, të përdorura në klasë, kategorizohen edhe nga llojet e të menduarit në të cilat përfshihen nxënësit gjatë zhvillimit të mësimin. (MUSAI, Mësimdhënia dhe të nxënësve ndërvprues-Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve, 2005)

Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies trajton aspektet e mësimdhënies që janë thelbësore në zhvillimin e të gjitha veprimtarive që mësuesi ndërmerr në klasë. Për të qenë i suksesshëm mësuesi lipset të njohë mirë lëndën e tij, procesin e mësimdhënies; bazat teorike të ndërtimit dhe organizimit të sistemit mësimor, parimet e psikologjisë së edukimit, metodologjinë e mësimdhënies dhe gjithashtu të pajiset me shkathësi e shprehi për të zhvilluar mësimin në klasë.

Zhvillimi i vullshëm i shoqërisë së sotme si dhe rritja me ritme marramendëse e informacionit i ndihmuar nga mjetet e shumëllojshme të transmetimit, kanë bërë të mundur që mësimdhënia të ndryshojë nga ajo e dekadave të mëparshme. Më parë mësuesi ishte burim informacioni, masë për gjithçka, ndërsa sot ai është një udhëheqës dhe organizues i mësimin që udhëheq nxënësin për të kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe me ndihmën e tij të zgjidhë çdo problem sado i ndërlikuar që të jetë. Sot në qendër të mësimin është nxënësi. Mësuesi rregullon dhe përshtat interesat dhe nevojat e tij me synimet e mësimdhënies. Mësuesi i ndërton veprimtaritë në klasë me synimin që të arrijë të krijojë tek nxënësit, njohuri, shprehi, përvujtë dhe vlera.

Për të qenë të sigurtë, mësimdhënia sikurse praktika mjekësore është shumë art, ajo kërkon ushtrimin e talentit dhe krijimtarisë. Por sikurse mjekësia, ajo është gjithashtu, ose duhet të jetë shkencë. Për këtë ajo përmbledh një repertor teknikash, procedurash dhe aftësish që duhet të studiohen sistematikisht dhe të përshkruhen, e kështu të transmetohen dhe përmirësohen. Mësuesi i madh është ai që shton krijimtarinë dhe frymëzimin tek ky reporter bazë. Karakteristikat e mësimdhënies janë:

- Mësimdhënia është një proces i orientuar drejt qëllimit.
- Ajo ka lidhje të ngushtë me përmbajtjen.
- Mësimdhënia është e orientuar drejt një grupi të vecantë njerëzish.
- Mësimdhënia është një proces i planifikuar.
- Mësimdhënia shfrytëzon strategji të shumta.
- Mësimdhënia shfrytëzon mjete të shumta.
- Mësimdhënia karakterizohet nga funksionimi i vazhdueshëm i procesit të vlerësimit.
- Mësimdhënia është një kompleks marrëdhëniesh.

Pra, mësimdhënien mund ta shohim si: komunikim(aspekti social), e ndërtuar për një arsye të vecantë(qëllim), e ndërtuar me një përmbajtje të vecantë(temë, problem), ndodh në rrethana të caktuara(kuadri), përdor burime të ndryshme(materialet). (MUSAI, Mjeshtritw themelore tw mwsimdhwnies, 1996)

Mësimdhënia është një veprimtari ndërpersonale, ndërvepruese që në mënyrë tipike përfshin komunikimin gojor, që ndërmerret me synimin për të ndihmuar një ose më shumë nxënës të mësojnë apo të ndryshojnë mënyrat sipas të cilave ata mund apo do të sillen. (MUSAI, Psikologji Edukimi zhvillimi, tw nxwnwt, mwsimdhwnia, 1999). Në zhvillimet e përgjithshme shoqërore, politike, ekonomike, shkencore e teknologjike, është më se e domosdoshme edhe ndryshimi i mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shkolla duhet të jetë në hap me këto ndryshime, përndryshe nuk do të mund ta luaj rolin dhe funksionin e saj edukativo-arsimor. Në teorinë pedagogjike janë të njohura disa prej tyre, përdorimi i të cilave ndikon në planifikimin dhe organizimin e mësimdhënies bashkëkohore.

Mësimdhënia ndërvepruese nënkupton bashkëpunimin dhe ndërveprimin mësimdhënës-nxënës, nxënës-nxënës ku secili ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta. Në mësimdhënien ndërvepruese nxënësi dhe mësimdhënësi janë dy faktor të rëndësishëm në procesin mësimorë. Nxënësi është pikënisje në planifikimin e punës mësimore.

Mësimdhënia me në qendër nxënësin- Ndryshe nga mësimdhënia tradicionale ku mësuesi ishte në qendër të procesit mësimorë, mësimdhënia me nxënësin në qendër nga vet emërtimi na bënë të kuptojmë se në qendër të mësimdhënies dhe të të nxënës është nxënësi me karakteristikat e tij vetanake. Qëllimi i kësaj mësimdhënie është përvetësimi i njohurive dhe zhvillimi i shkathtësive e aftësive që nënkupton edhe aftësimin e nxënësve për të përdorur burimet e informacionit në mënyrë të pavarur. Kjo mënyrë e punës, të nxënës dhe ndërveprimit në procesin e mësimdhënies me në qendër nxënësin dhe zhvillimit të aftësive i ka vendos themelet e mësimdhënies bashkëkohore. Prandaj është përgjegjësi e institucioneve edukativo-arsimore për krijimin e një mjedisi të të nxënës ndërveprues, ku nxënësit mësojnë duke vepruar, bërë dhe duke përdorur nivele më të larta të të menduarit. Pra karakteristikë e mësimdhënies me në qendër nxënësin është të nxënës. (autorwsh, Mësimdhënia e integruar dhe të mësuarit me tema., 2005)

Mësimdhënia e diferencuar- Duke u nisur nga vetë natyra e nxënësve, që asnjë nxënës nuk është i njëjtë me tjetrin për nga ana trupore, mendore (aftësitë), përvoja, rrethi shoqëror, interesat, nevojat, ndjenjat, prirjet etj. Atëherë është e nevojshme që secili nxënës të mësoj sipas mënyrës së veët. Këto dallime midis nxënësve përcaktojnë format e punës, metodat dhe teknikat mësimore, stilet e të nxënës, mjetet etj. Në këtë rast shtrohet nevoja për mësimdhënie të diferencuar. Në mësimdhënien bashkëkohore përdoren strategji të ndryshme, por asnjëra nuk mund të jetë e përshtatshme për të gjithë nxënësit dhe të arrihen suksese të larta. Prandaj është e nevojshme të përzgjedhen strategji të mësimdhënies dhe t'u përshtaten nevojave e dallimeve në mes nxënësve të ndryshëm.

Mësimdhënia e integruar nënkupton zhvillimin e procesit mësimorë dhe përvetësimin e njohurive nga jeta e përditshme e nxënësve, përvoja e tyre si dhe të ndërlydhura në lëndë të ndryshme. Kjo mësimdhënie ndryshe quhet edhe ndërdisiplinore, sepse mësimet, njohuritë janë në lidhshmëri

në mes të lëndëve të ndryshme: gjuha, matematika, arti, muzika, lëndët natyrore dhe shoqërore. Pra në këtë rast bëhet ndërlidhja e lëndëve përmes projekteve në tema të ndryshme.

Mësimdhënia tematike përfshinë të nxënit me tema që mundëson ndërlidhjen e lëndëve dhe fushave mësimore, ku përmbushet mësimdhënia e cila zhvillon aftësitë, shkathtësitë, shprehitë e nxënësve me anë të ndërveprimit të tyre. Planifikimi i punës mësimore mbështetet në tema mësimore. "Mësimdhënia tematike realizon integrimin e fushave tematike dhe të disiplinave të ndryshme për të eksploruar një ide interesante, për t'i dhënë përgjigje një çështjeje për të analizuar e diskutuar një temë nga shumë këndvështrime dhe në lëndë të ndryshme.

Të nxënit përmes projekteve nënkupton përfshirjen e nxënësve në veprimtaritë grupore, përmes të cilave nxënësit mësojnë duke krijuar risi, gjëra të reja. Vetë natyra e të nxënit dhe punës kërkon jo një orë por disa sosh, për të përfunduar projektet. Kryesisht në projekte trajtohen tema nga përvoja dhe jeta shoqërore e nxënësve.

Mësimdhënia kërkimore nënkupton të mësuarit në mënyrë aktive ku nxënësi zbulon, gjenë njohuritë, jep përgjithësime nëpërmjet të menduarit logjik dhe të pavarur.

Gjatë procesit të të mësuarit nxënësit i zhvillojnë aftësitë e tyre duke zbuluar të vërtetat dhe arritjen e sukseseve në të nxënë. Mënyrat më të përshtatshme për përmbushjen e mësimdhënies kërkimore janë: projektet kërkimore, studimi i rastit, të mësuarit duke vepruar, diskutimeve etj.

Mësimdhënia hap pas hapi-Është një nga mësimdhëniet bashkëkohore ku në qendër ka nxënësin, nevojat, interesat, aftësitë e tij. Pra nxitë individualizimin e punës mësimore, organizimin veprimtarive të nxënësve të mbështetura në përvojën e tyre. Mjedisi i klasës ndahet në qendra mësimore, që krijohen kushte për ndërveprim dhe bashkëpunim të nxënësve." Një ndër vetitë karakteristike të mësimit hap pas hapi, pos vlerës afirmative të individualizimit të plotë mësimorë, në të elementet e strategjisë didaktike janë të përqëndruara drejt zhvillimit të kreativitetit të nxënësve në të gjitha etapat zhvillimore të procesit mësimorë. (Zylfiu, 2011)

KAPITULLI II

SHQYRTIMI I LITERATURËS

Mësimdhënia e suksesshme është para së gjithash e lidhur me krijimin e një veprimtarie të të nxënit për cdo nxënës. Arti i një mësimdhënie të suksesshme është domosdoshmërisht i lidhur me zhvillimin e:

1. Shprehive për marrjen e vendimit (cfarë tipi të të nxënit do të përdorë, strategji e teknika mësimore);
2. Shprehitë e të vepruarit.

“Dallimi ndërmjet këtyre dy tipareve të shprehive është tepër i rëndësishëm, sepse mësimdhënia është sa veprimtari e të menduarit aq edhe e veprimeve kontrolluese.” (Musai, 1996)

“Secili mësimdhënës duhet të jetë i përgatitur që të dijë strategji të ndryshme të mësimdhënies, sepse u duhet që t’i mbajnë nxënësit të angazhuar dhe kurioze, në mënyrë që ata të mos mërzhiten gjatë përvetësimit të përmbajtjeve mësimore. Po ashtu, metodat e përdorura në mësimdhënie patjetër duhet t’u përshtaten moshës së nxënësve.” (MacDonald)

“Kur të vendosni se cilat metoda të përdorni në mësimdhënie është e rëndësishme të kujtoni se metodat dhe teknikat janë vetëm hapa për të arritur një qëllim, dhe jo një qëllim në vetvete. Mësuesit duhet të zgjedhin metoda që do t’i ndihmojnë më mirë studentët të kuptojnë përmbajtjen, doktrinat dhe parimet e një blloku të veçantë të shkrimit të shenjtë dhe që do të ndihmojnë lartësimin dhe zbatimin. Të kujtuarit e qëllimit për përdorimin e një teknike ose metode të veçantë do t’i ndihmojë mësuesit ta zbatojnë atë në një mënyrë më kuptimplote. Gjithashtu, është e rëndësishme që të mbahet mend se pa Shpirtin, edhe metodat dhe përjasjet më të efektshme të mësimdhënies nuk do të kenë sukses.” (Solt-Lejk-Siti, 2012)

Zhvillimi i vrullshëm i shoqërisë ka bërë që mësimdhënia të ndryshojë. Dikur mësimdhënësi ishte burim informacioni, ndërsa sot, ai është udhëheqës dhe organizues i mësimit që udhëheq nxënësin për ta kërkuar në mënyrë të pavarur informacionin dhe e pajis me metodologjinë, i zhvillon mendimin dhe gjykimin që të zgjidhë cdo problem. Sot në qendër të mësimit është nxënësi. Mësimdhënësi rregullon dhe përshtat mësimdhënien dhe objektivat e saj varësisht nevojave të nxënësve.

Mësimdhënësi synon që me veprimtaritë në klasë të arrijë të krijojë te nxënësit: njohuri, shprehje, përvojë dhe vlera të qëndrueshme. Ndaj ai siguron që mësimdhënia të plotësojë tri kushte:

1. Të aktivizojë dhe të mbështetë vëmendjen e nxënësve gjatë procesit të të nxënës;
2. Të mbështesë nxënësit në përpjekjet e tyre për të nxënë;
3. Të përshtatë veprimtaritë e të nxënës me stilin e të nxënës që dëshiron mësimdhënësi të nxisë. (Musai B. , 1999)

Përdorimi i metodave efektive për motivimin e nxënësve duhet të shihen si një aspekt shumë i rëndësishëm në mësimdhënie. Motivimi është njëri ndër faktorët kryesorë që e përcakton suksesin në mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqipe. (Cheng & Zoltan Dornyei, 22 Dec 2008) Mësimdhënia nuk është monolog, por dialog; në të cilin njëri partner apo person është i zëshëm, ndërsa personi tjetër me anë të shprehjeve të fytyrës apo me gjestikulacione bëhet pjesë e dialogut. Procesi modern i mësimdhënies përbëhet prej këtyre tri bazave:

1. Vendosja e nxënësit në qendër të vëmendjes;
2. Udhëzimi i nxënësve;
3. Nxitja e zhvillimit të nxënësve. (KOCHHAR)

“Mësimdhënësit janë burim i pashtershëm, gjithmonë në pasurim të ideve dhe materialeve më të vlefshme, që përgatitin dhe përdorin me nxënësit e tyre. Ata duhet të sigurohen që metoda e përdorur të harmonizohet me qëllimet e të nxënës dhe në cdo rast t’i përshtaten nevojave që kanë. Përdorimi i metodave atraktive, kontribuojnë në formimin e nxënësve me cilësitë e qytetarëve të një shoqërie demokratike dhe të bazuar në dije. Në vend të përvetësimit të njohurive, sot kërkohet nga nxënësit të ndërtojnë dhe të krijojnë vetë njohuri.” (MUSAI, 2005)

Teknikat apo metodat e mësimdhënies janë mjetet që pasqyrojnë suksesin e procesit të të nxënës dhe kompetencat e mësimdhënësit. Duke qenë mësimdhënë, gjithmonë ke nevojë të kërkosh metoda të reja dhe efektive për t’u dhënë njohuri nxënësve dhe në shumë raste mund ta shohim se metodat tradicionale të mësimdhënies nuk janë efektive. Disa nga kriteret që duhen plotësuar për të zgjedhur metodën e mësimdhënies janë:

1. A është e përshtatshme metoda për kohën të cilën e kemi të lejuar?
2. A u jep mundësi pjesëmarrjeje të gjithë nxënësve?

3. A munden nxënësit të shkëmbejnë ide dhe mendime?
4. A u jep mundësi nxënësve për të bashkëpunuar?
5. A u jep mundësi nxënësve të jenë vetëvlerësues?
6. A u jep mundësi për ndërlidhje me tema të tjera?
7. A u jep mundësi përdorimi të teknologjisë etj.

“Metodat më të suksesshme janë ato të cilat i plotësojnë kriteret e mësipërme.” (Al-Ravvi, 2007)

“Për mësuesit sfida qëndron në aftësinë për të ndërtuar një model hipotetik të botëve konceptuale të nxënësve, edhe pse këto botë mund të jenë shumë më të ndryshme nga ajo që nënkupton mësuesi.” (Fosnot, 1996)

Metodat dhe llojet e tyre

Përdorimi i metodave efektive ka rëndësi shumë të madhe në mësimdhënie, sepse ato ndihmojnë në zhvillimin e mendimit kritik, në krijimin e një ambienti të përshtatshëm në klasë, në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore; nxënësit janë më të cilruar, diskutojnë më shumë, punojnë me dëshirë, janë më bashkëpunues etj. Por, përkundër këtyre benefiteve, problemi qëndron se këto metoda nuk përdoren mjaftueshëm në shkollat tona, përfshirë edhe komunën e Ferizajt, ku mësimdhënësit preferojnë të përdorin metoda tradicionale, pra me mësimdhënësin në qendër. Me metodat tradicionale kemi vënë re cektësi në të kuptuarit e nxënësve dhe njohuri pasive në të gjitha moshat dhe klasat, përfshirë këtu edhe universitetet.

Metoda të mësimdhënies në klasë, të klasifikuara sipas veprimtarive të nxënësve

- Zhvillimi i fjalorit (Ndodh krahas përvetësimit të koncepteve të reja dhe kuptimit të lidhur me to.)
 Analiza e tipareve semantike
 Harta e konceptit
 Organizuesi grafik i analogjisë
 Përvijimi i të menduarit
 Metodat mësimore të renditura më lart ndihmojnë në qartësimin e kuptimit të fjalëve dhe marrëdhëniet e tyre me një koncept të caktuar apo në një përmbajtje të dhënë.
- Diskutimi i ideve (apo sic njihet ndryshe, brainstorming i ideve, është një nga mënyrat më të thjeshta për t’i përfshirë nxënësit në një proces që të mendojnë në mënyra të ndryshme. Nxënësit kanë ide të shumta ndaj duhet krijuar mundësia t’i shfaqin ato ide, t’i diskutojnë, t’i pëeqasin. Qëllimi i diskutimit të ideve është t’i tërheqë fëmijët që të përvijojnë ide, sa më shumë të jetë e mundur, në lidhje me çështjet që diskutohen.
 Di-Dua të Di-Mësova

Diskutimi për njohuritë paraprake

Shpjegimi i përparuar

Sistemi ndërveprues i shënimeve

- Të nxënësit bashkëpunues (i aftëson nxënësit të punojnë në grupe të vogla e të larmishme në përbërje, heterogjene, për qëllime të vecanta, ku secili i ndihmon njëri-tjetrit dhe gjallon një mjedis ku pranohet me lehtësi bashkëpunimi, nuk ka rrezik në bashkëpunim dhe ekziston ndjenja e përkatësisë.) Struktura e të nxënimit në bashkëpunim bazohet në pesë elemente bazë:
 1. Varësi ndërvepruese (qëllime të përbashkëta, shpërblime të përbashkëta)
 2. Ndërveprim ballë për ballë (përmbledhje gojore, dhënie dhe marrje e shpjegimeve, përpunim.)
 3. Përgjegjësi individuale (mbështetje e grupit për punë individuale, test individual për secilin nxënësit.)
 4. Shprehje bashkëveprimi në grup (përvetësim i shprehjeve të ndërveprimit shoqëror, përfshirë komunikimin, udhëheqësinë, besimin, vendimmarrjen dhe zgjidhjen e konflikteve.
 5. Përpunim në grup (kohë dhe procedura për të analizuar efektshmërinë dhe dobinë e funksionimit në grup. (Johnson, 1990)

Rrjeti i diskutimit

Të nxënësit me këmbime

Ruaje fjalën e fundit për mua

Rishikimi në dyshe

- Nxitja e diskutimit (Diskutimi ndodh përgjatë tërë orëve të mësimit, në situata nga më të llojllojshmet, diskutimi nxit të menduarit, kur nxënësit dëgjojnë me vëmendje dhe kujdes për ato që thonë të tjerët dhe, më pas, modifikojnë apo zgjerojnë të menduarit e tyre.)

Diagrama piramidale

Leximi i drejtuar

Diskutim për njohuritë paraprake

Parashikimi me terma paraprakë

- Të lexuarit ndërveprues (gjatë këtij procesi veprojnë shumë faktorë, ku ndër më kryesorët mund të vecojmë ata faktorë që realizojnë ndërveprimin tonë si lexues me tekstin. Kështu kuptimi ndërtohet duke përfshirë: ndjenjat dhe emocionet për temën, njohuritë fillestare në lidhje me lëndën, qëllimin dhe motivimin për studimin e pjesës së zgjedhur, përshtatshmërinë dhe vlefshmërinë për të zbatuar informacionin në situata reale jetësore, bindjet e formuara më parë dhe përceptimet.)

Imagjinata e drejtuar

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Pyetja sjell pyetjen

Pyetje autorit

- Nxitja për të përsosur të shkruarit (Të shkruarit është mënyrë për të zhvilluar të menduarit, sikurse të folurit dhe të lexuarit. Gjatë kohës kur nxënësit shkruajnë kryejnë këto veprime:

shqyrtojnë c'dinë dhe mendojnë, gjejnë idetë dhe përzgjedhin, përpunojnë të shkruarit, miratojnë, pohojnë dhe përforcojnë ato që dinë.)

Dritaret e të nxënës

Përmbledhja pohim/mbështetje

Shënime mbi shënime

- Paraqitja grafike e informacionit (është paraqitje pamore që tregon marrëdhëniet midis koncepteve, ideve, linjave apo elementeve të një tregimi. Ai është paraqitje mendore, që e bën të menduarit të dukshëm, i aftëson nxënësit të të rrokin lehtësisht dhe shpejt idetë kryesore dhe strukturat organizuese. Organizuesit grafikë janë disa tipe: krahasimi dhe kontrasti, zhvillimi i fjalorit, zhvillimi i koncepteve, organizimi, marrëdhënie të tjera.

Analiza e tipareve semantike

Diagrama piramidale

Harta e konceptit

Përmbledhje e lidhjeve në shkencat e natyrës

- Ndërtim i shprehive studimore (së pari nxënësit është e nevojshme të përfshihen mendërisht me qëllim që të ndodh procesi i të nxënës, pastaj duhet të bëjnë lidhjen dhe të përpunojnë e organizojnë në mënyrë më të thellë.)

Leximi i drejtuar

Marrëdhëniet pyetje-përgjigje

Rishikimi në dyshe

Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues

Me përdorimin e këtyre metodave dhe shumë të tjerave që ekzistojnë apo që mund t'i krijosh si një mësimdhënës dhe të ja përshtatësh njësisë mësimore të bëjnë të ndjehesh i përfshirë në profesion.

Roli i përdorimit të metodave efektive në të nxënës e nxënësve

Mësimdhënia është një detyrë e ndërlikuar dhe me shumë aspekte për t'u marrë në konsideratë. Një listë e metodave apo teknikave për mësimdhënie do të përfshinte shumë ide e shembuj, dhe një diskutim i plotë për to do të zinte volume të tëra. Mësuesit duhet të zgjedhin metoda që do t'i ndihmojnë më mirë studentët të kuptojnë përmbajtjen, doktrinën dhe parimet e një blloku të veçantë të shkrimit të shenjtë dhe që do të ndihmojnë lartësimin dhe zbatimin. Të kujtuarit e qëllimit për përdorimin e një teknike ose metode të veçantë do t'i ndihmojë mësuesit ta zbatojnë atë në një mënyrë më kuptimplote. Gjithashtu është e rëndësishme që të mbahet mend se pa shpirtin, edhe metodat dhe përjasjet më të efektshme të mësimdhënies nuk do të kenë sukses.

Teknologjia dhe përdorimi i metodave ka transformuar mënyrën e mësimdhënies dhe të nxënës por duke transformuar procesin ajo po transformon dhe rezultatin. Ka shumë avantazhe të përdorimit

të teknologjisë në klasë si për shembull: ajo e bën nxënësin më të interesuar për temën mësimore, zvogëlon kohën e të mësuarit si dhe ofron mundësi për të mësuar në mënyrë jotradicionale.

Përdorimi i pajisjeve kompjuterike mbështet metodat e të nxënësve për të nxënë me aftësi të ndryshme për të nxënë, kështu përdorimi i tyre ndihmon nxënësit me aftësi të ndryshme konceptuale si dhe nxënësit me nevojat të veçanta në përthithjen e të shpejtë të koncepteve të reja gjatë një teme çfarëdo mësimi. Po ashtu mësuesit dhe prindërit pranojnë faktin se për shkak të përdorimit të pajisjeve kompjuterike nxënësit dhe fëmijët e tyre e përdorin më me efikasitet kohën e tyre të punës. Përdorimi i teknologjisë në klasë gjithashtu ka një efekt pozitiv në qëndrimet e nxënësve pasi ata ndjehen më të suksesshëm, më të motivuar për të mësuar dhe shfaqin më shumë vetëbesim. Teknologjia dhe përdorimin e metodave mund ta ndihmojë dhe e ndihmon nxënësin të zhvillojë të gjitha llojet e aftësive nga ato më të thjeshtat deri te ato më të ndërlikuarat. Megjithatë, që teknologjia dhe metodat të jenë të suksesshme, mësuesi duhet të bëjë zgjedhje të informuara në lidhje me qasjen pedagogjike, nevojat e nxënësit dhe rezultatet e të nxënësve. Për mësuesin, sa e rëndësishme është të dijë se për çfarë do ta përdorë teknologjinë, po aq e rëndësishme është të dijë dhe mënyrën se si e nxëna mund të përmirësohet përmes teknologjisë dhe metodave.

Detyra e mësuesit është të bashkërendojë informacionin e duhur në një mënyrë të përshtatshme për të ndihmuar nxënësin ta kuptojë atë. Aktivitetet vizuale me programet kompjuterike mund të jenë komponentë thelbësorë për të ndihmuar nxënësin të shohë se si konceptet zbatohen në situata reale. Kjo i jep mundësi nxënësit për të eksploruar mjedise më komplekse. Një shembull i përdorimit të teknologjisë janë simulimet nëpërmjet lojërave kompjuterike ku nxënësit luajnë rolin e vendimmarrësit në situata historike në mënyrë që të shikojnë rëndësinë e këtyre ngjarjeve në jetën e tyre të përditshme dhe të zhvillojnë më mirë aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit. Forma të tjera të përdorimit të teknologjisë janë dhe udhëtimet virtuale në kohë. Nxënësit mësojnë rreth kulturave të ndryshme duke parë fotografi, filma, videoklipe, prezantime në poëer-point dhe tekste të përzgjedhura. Nxënësit, gjatë navigimit nëpër udhëtimin virtual, u përgjigjen pyetjeve të mësuesit. Duke përdorur teknologjinë dhe përdorimin e metodave në qasjen konstruktiviste mësuesit e kanë më të lehtë të përfshijnë nxënësit në aktivitetet mësimore. Ata mund të krijojnë aktivitete për nivele dhe stile të ndryshme të të nxënësve si dhe mund të zgjerojnë gamën e informacioneve që janë në dispozicion të nxënësit. (ALBAS)

Aplikimi i metodave në lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe

Lënda e gjuhës dhe letërsisë shqipe bën pjesë në fushën “Gjuhët dhe komunikimi”. Kjo fushë i aftëson nxënësit që të përdorin saktë gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Mësimi i gjuhës shqipe zhvillon te nxënësit të menduarit kritik dhe i bën të vetëdijshëm për identitetin e tyre personal dhe kombëtar. Nëpërmjet leximit të teksteve nga letërsia shqipe dhe ajo botërore, nxënësit zhvillojnë botën e tyre emocionale, pasurojnë përfytyrimet dhe imagjinatën e tyre për botën, çmojnë dhe vlerësojnë gjuhën e kulturën kombëtare dhe ato botërore. Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” nxit dëshirën dhe kuriozitetin e nxënësve për t’u bërë lexues aktivë e të pavarur dhe

shkrues të saktë, origjinalë dhe krijues. Po kështu, ajo zhvillon te nxënësit njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat e duhura që ata të flasin dhe të dëgjojnë në mënyrë korrekte në varësi të situatës dhe të qëllimit që kanë. Një nga qëllimet kryesore internacionale të të ardhmës për botën është konstruktimi i një shoqërie të qëndrueshme. Një shoqëri e qëndrueshme mendohet të jetë një shoqëri që ka arritur qëndrueshmërinë sipas një procesi të quajtur zhvillimi i qëndrueshëm. (Kopnina, 2012) Përfshirja e nxënësve në vendimmarrje në klasë është gjithashtu një mënyrë e nxitjes së mësimdhënies dhe të të nxënësve emocional. Kur mësuesi merr vendime me nxënësit në lidhje me përmbajtjen, detyrat, afatet, tekstet e klasës, dhe të mësuarit në të ardhmen, ata ndjehen të fuqishëm, të dobishëm dhe kjo e bën të gjithë procesin më demokratik, gjithashtu, kjo ndihmon që ta shohin mësuesin si bashkëpunor, menaxher, drejtues dhe e largojnë idenë e gabuar që një mësues është vetëm një autoritar, puna e të cilit është që t'i thotë nxënësve çfarë të bëjnë apo çfarë të mos bëjnë ose për të parandaluar veprimet, dhe të bëjnë gjykime në klasë. Nga ana tjetër, ata fillojnë të mendojnë se mësuesi është një lehtësues, i cili është i hapur për problemet e tyre dhe që luan rol kryesor në të mësuarit e tyre. (TAFANI.V., 2003)

Aplikimi i metodave përdoret për të ndërtuar strukturat e të menduarit të nxënësve dhe për të kultivuar qëndrime dhe vlera, pra metodat dhe teknikat duhet të përshtaten me natyrën e lëndës dhe qëllimet e të nxënësve. (IZHA, 2014-2018)



Figura 1: Përdorimi i metodës “Alfabeti i njëpasnjëshëm i tryezës së rrumbullakët” (Burimi: Portali Shkollor)

Kjo teknikë përdoret që nxënësit të kujtojnë terma, fakte ose ngjarje për një temë ose një grup temash mësimore, si dhe që të pasurojnë fjalorin. P.sh., në fazën e fundit të një ore mësimi, nxënësit e klasës së gjashtë që janë njohur dhe kanë punuar me disa poezi për atdheun, plotësojnë në grupe tabelën me fjalë që kanë lidhje me atdheun. (autorwsh, 2004)

Duhet ta kemi parasysh që orët e gjuhës shqipe ndryshojnë nga njera-tjetra, sepse lënda e gjuhës shqipe është mjaft e gjerë²⁹. Ajo përfshin njohuri rreth fonetikës, leksikologjisë, morfologjisë, sintaksës, pikësimit, etj; ka një numër të madh orësh për ushtrime, përfshin diktime, detyra e punë të pavarura të ndryshme në shkrim. Çdo orë mësimi ka një qëllim të caktuar mësimor, ky qëllim mësimor lidhet me një pjesë të caktuar të programit që ka si pikësynim të japë e të ngulitë njohuri gjuhësore tek nxënësit, t'i aftësojë ata për ti zbatuar në praktikë njohuritë e përvetësuar. Sigurisht, për ndërtimin e çdo ore mësimi ka rëndësi edhe njohja nga ana mësuesit se deri në ç'shikallë i zotërojnë nxënësit njohuritë e dhëna në klasë, njohuritë e reja, cila është shkalla e përvetësimit të tyre dhe së fundi, ka rëndësi të njihen edhe veçoritë e klasës në përgjithësi dhe veçoritë psikologjike të nxënësve në veçanti. Pikërisht për këto arsye çdo orë mësimi ka një ndërtim të veçantë, i cili përcaktohet nga faktorë pedagogjiko-metodike dhe lëndore, kalon nëpër disa etapa, të cilat lidhen kurdoherë me vetë detyrat e saj. Etapat kryesore për çdo orë në lëndën e gjuhës shqipe janë: 1. kontrolli i detyrave të shtëpisë; 2. kontrolli i përvetësimit të njohurive të meparshme; 3. paraqitja e temës së re. (Memushaj, 2006)

Benefitet nga përdorimi i metodave në mësimdhënie

Teknologjia e përdorur në mësimdhënie dhe përdorimi i metodave efektive ka ndikim pozitiv në të nxënësit e nxënësve apo studentëve. Mësuesit dhe nxënësit të përdorin metodat e mësimdhënies me bazë teknologjinë - metoda me në qendër nxënësin, – me qëllim rritjen e benefiteve në kuadër të të nxënësit dhe nxënësve me nevojë të veçanta kanë mundësi më të prekshme për të realizuar të nxënësit produktiv, kur aplikohet teknologjia në mësimdhënie, mësuesi është më i prirur të lejojë nxënësit në pjesëmarrje më aktive dhe udhëheqëse, metodat e mësimdhënies me bazë teknologjinë ndihmojnë në zhvillimin e proceseve të larta mendore të nxënësit. (Prezi)

Dominimi i metodave tradicionale të cilat e fuqizojnë njohurinë enciklopedike dhe jo specifike apo praktike, mungesa e mësimdhënies interaktive dhe inovacioneve bëjnë që teknologjia informatike e komunikimit të shfrytëzohet si reformator për t'i plotësuar kërkesat globale për mësimdhënie sa më pragmatike dhe për ti ndjekur trendet bashkëkohore arsimore ku nxënësi vendoset në qendër të vëmendjes dhe ku amplifikohet të menduarit kritik dhe zgjedhja e problemeve. Nevoja dhe arsyeja e aplikimit të TIK-ut në arsim niset nga fakti i përgatitjes së të rinjve për tu bërë liderë dhe të suksesshëm në këtë shoqëri të udhëhequr nga informacionet. Aftësitë e komunikimit, procesimit, mendimit kritik dhe zgjedhjes së problemeve si dhe puna në grupe janë esenciale. Bashkëveprimi gjatë mësimi bëhet në disa mënyra – për shembull: nxënës me nxënës, nxënësi me grupin, dhe grupi me grupin. Nxënësit munden që gjithashtu të bashkëveprojnë me njerëz të ndryshëm si me shokët e klasës, mësuesin, nxënësit e klasave të tjera, anëtare komunitetit, ekspertë nga jashtë, dhe njerëz nga e gjithë bota. (Hungary, 2006)

Përdorimi i teknologjisë dhe metodave në shkollat tona ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme këto vitet e fundit. Kështu, për të pajisur nxënësit me aftësitë e nevojshme teknologjike, duhet të përdorim metoda të reja të të mësuarit në krahasim me metodat e përdorura në të mësuarit tradicional. Teknologjia dhe mjetet teknologjike janë bërë pjesë e edukimit në shkolla dhe synimi

është të përdorim teknologjinë në klasa si një mjet që zhvillon dhe nxit më tej procesin e të mësuarit. Nxënësit, nga përdorimi i këtyre mjeteve të reja teknologjike kanë përfituar aftësi kompjuterike, aftësi të cilat do të mund t'i përdorin në të ardhmen në vendet e tyre të punës.

Benefitet e përdorimit të metodave bashkëkohore janë:

- Mbajtja dhe drejtimi vëmendjes (Kompjuteri e tërheq vëmendjen me ndihmën e ngjyrave, zërave dhe fotografive interesante. Vëmendja është më e madhe para kompjuterit pasi që njohuritë fitohen përmes lojës. Shembull: Nxënësit të cilët kanë probleme me sjelljen (nxënës hiperaktiv, nxënës me vështirësi gjatë mësimit) mund të kenë vëmendje më të gjatë para kompjuterit gjatë mësimit klasik.)
- Kënaqësia (Metodat janë burim i kënaqësisë, që paraqet faktor të rëndësishëm për sukses. Çdo detyrë e kryer me sukses për të cilën nxënësi merr lavdërime i jep vetë besim dhe e rritë dëshirën e tij për sukses.)
- Autonomia (Metodat dhe teknologjia i lejon që të tejkalohen një pjesë të mossukseseve me të cilat zakonisht has nxënësi kur punon me mjetet shkollore. Nxënësi mund të realizojë ndonjë aktivitet në tërësi me pjesëmarrje minimale të personit të tretë, i cili do t'i ndihmojë gjatë punës me veglat. Shembull: Nxënësi me paralizë cerebrale ka vështirësi gjatë të shkruarit me laps në fletore. Përjeton pengim dhe mossukses gjatë realizimit të këtij aktiviteti. Me ndihmën e aparateve asistive dhe kompjuterin pavarësisht shkruan, është më i shpejtë dhe i lumtur për kryerjen me sukses të aktivitetit.)
- Përshtatshmëria (Llojshmëria e mbështetjes dhe të veglave teknike lejon që të përshtatet vegla kompjuteristike dhe/ose përmbajtjet e nxënësve të ndryshëm. Shembull: Aparatet e ndryshme asistive dhe softueri përshtatet ndaj nevojave, mundësive dhe interesimeve të çdo nxënësi. Nuk ekziston nxënës me nevoja të veçanta arsimore i cili nuk do të mund të përdorë kompjuter.)
- Ndjenja e vlerësimit (Kompjuteri ofron ndjenjë të vlerësimit dhe vetë vlerësimit të nxënësit. Ai është burim i marrjes së përgjegjësisë dhe pjesëmarrje në grup dhe kontribuon në stabilizimin e sjelljeve.) (Zwiers, 2005)

Pengesat në përdorimin e metodave efektive

Zbatimi i mësimdhënies interaktive kërkon mjete të ndryshme ndihmëse për mësim, hapsirë të volitshme për punë, rregullim të interierit, aftësim të arsimtarëve për të zbatuar mësimdhënie interaktive, aftësim i nxënësve e të tjera që do të thotë se mvaret nga shumë faktor të rëndësishëm. Që të ndryshohet pasqyra e mësimit tradicional si çështje mjaft e rëndësishme është vendosja e risive në mësim.

Në teorinë praktike të didaktikës është pranuar qëndrimi për ndryshimin e mësimit pasiv ndaj atij aktiv. Mënyra aktive e organizimit të mësimit e karakterizon mësimin bashkëkohor, ndërsa mënyra pasive e karakterizon mësimin tradicional.

- Procesin e të nxënimit aktiv e dallojnë disa karakteristika nga mësimi i rëndomtë, ndër të cilat me rëndësi janë :strukturim tjetërfare i përmbajtjes së temës, njësisë mësimore, planifikimit dhe përgatitjes për mësim;
- Trajtim gjithpërfshirës i temës mësimore;
- Kombinim qenësor i materialit teorik dhe praktik;
- Dominim i punës së individualizuar ose i punës së kombinuar individuale – grupe;
- Punë e pavarur e grupeve brenda orës mësimore për disa lëndë ose aktivitete mësimore dhe ndërrimi i roleve në orën tjetër;
- i pozitës aktive të nxënësve dhe roli drejtues e organizues i arsimit;
- qasje e punës në grupe, kontroll i drejtpërdrejtë, ndihmë nga nxënësit tjerë dhe kooperim ndërmjet nxënësve;
- klasa transformohet në një ambient pune dhe nxënijeje;
- ka organizim të të nxënimit;
- nxitja pozitive sipas shfrytëzimit të metodologjive dhe teknologjive efikase mësimore. (Reci)

Përdorimi i metodave efektive në kurrikulë

Sipas Kornizës së Kurrikulës konsiderohet se:

Qasja në njohuri/informacione dhe përpunimi i tyre në mënyrë të pavarur, efektive dhe me përgjegjësi është shumë e rëndësishme për mësimnxënie, për marrje të vendimeve dhe zgjidhje të problemeve duke qenë plotësisht të vetëdijshëm për ndikim dhe pasojat e tyre. Duke pasur parasysh kompleksitetin e shoqërisë dhe ekonomisë së sotme, menaxhimi i dijes është bërë kompetencë thelbësore për shekullin XXI. Megjithatë, përveç aftësisë për të identifikuar dhe për t’iu qasur informataës/burimit të njohurisë së caktuar, nxënësit kanë nevojë t’i zhvillojnë kapacitetet e tyre për t’iu qasur njohurive në mënyrë kritike, kreative dhe ndërvepruese. (BEP, 2013)

Rezultatet e pritshme të kësaj kompetence janë:

- të identifikojnë, të lokalizojnë dhe t’i qasen informatës së duhur
- ta përpunojnë (analizojnë, sintetizojnë, organizojnë, shfrytëzojnë dhe zbatojnë) informatën në mënyrë kritike,
- t’i zbatojnë njohuritë në kontekst të zgjidhjes së problemit përmes veprimeve të përshtatshme.
- të gjykojnë drejt,
- ta ilustronjë me mjete konkrete të menduarit abstrakt,
- t’i vlerësojnë mundësitë e ndryshme dhe të marrin vendime të drejta,
- t’i lidhin vendimet e tyre me pasojat në mënyrë të përgjegjshme,
- ta vetëvlerësojnë performancën vetanake krahas rezultateve të pritura,

- t'i menaxhojnë informatat në mënyrë kritike, kreative dhe të përgjegjshme,
- e zgjidhin problemin në nivelin e caktuar të vështirësisë. (MASHT S. , 2012)

Faktori kryesor në ekonominë e njohurive globale është informata dhe teknologjia. Në kohët e sotme duhet të jemi në gjendje të reagojmë shpejt dhe në mënyrë efikase ndaj ndryshimeve të shumta. Ekonomia e re kërkesat kryesore i ka në shkathtësi intelektuale, fleksibile dhe në aftësinë për t'i analizuar informatat dhe për t'i integruar burimet e shumta të njohurive në zgjidhjen e problemeve. Të menduarit kritik dhe përdorimi i metodave efektive i promovon shkathtësitë e tilla të të menduarit dhe është shumë i rëndësishëm në këtë treg të punës i cili po ndryshon aq shpejt.

Përdorimi i metodave efektive dhe të menduarit kritik: i zhvillon shkathtësitë e oratorisë dhe të prezantimit, e promovon kreativitetin, është thelbësorë për vetëreflektim, është baza e shkencës dhe demokracisë etj.

Shkathtësitë të cilat dëshirojmë që nxënësit e shkollës t'i përvetësojnë janë të dizajnuara për t'i zhvilluar shprehitë dhe praktikatat e të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe kërkojnë që nxënësi të mundohet që:

- Të gjejë kuptim në gjërat që i mëson,
- Të kërkojë ta kuptojë kontekstin e gjërë,
- Ta ndërlihdë mësimin e ri me njohuritë apo përvojat paraprake,
- Të kërkojë të gjejë modele apo parime të ngjashme,
- T'i kontrollojë faktet dhe t'i ndërlihdë ato me përfundimet e veta,
- Ta kuptojë logjikën e propozimeve dhe të jetë i gatshëm t'i sfidojë ato dhe të argumentojë në mënyrë kritike dhe me kujdes,
- Ta monitorojë të kuptuarit e vet gjatë progresit të të nxënësve,
- Të angazhohet rreth ideve të reja dhe të ndjej kënaqësi në sfidat individuale. (MASHT, 2016)

Përdorimi i metodave efektive gjatë pandemisë

Pandemia ka përkeqësuar thellësisht arsimin ekzistues dhe pabarazitë sociale në rajon. Fëmijë nga familje me të ardhura të ulëta, fëmijë që jetojnë në zona rurale me infrastrukturë të dobët, fëmijë nga pakica etnike dhe gjuhësore, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë migrantë dhe refugjatë, fëmijë në konflikt me ligjin, fëmijë jashtë sistemit shkollor dhe të rinj dhe djem e vajzat që jetonin ndryshe në rrethana të vështira ose shtëpi abuzive tanimë po përballëshin me barriera domethënëse për pjesëmarrjen në arsim dhe të nxënimit dhe duke përfituar arsim më të dobët dhe më pak rezultate shoqërore se bashkëmohatarët e tyre. Shkollat nuk janë vetëm vendi për të nxënimit akademik, por edhe për të nxënimit social dhe emocional, ndërveprimin dhe mbështetjen sociale. Mbyllja e shkollave nuk ka ndërprerë vetëm të nxënimit e fëmijëve, por edhe aksesin në vaktet në shkollë, mbështetjen e mirëqenies dhe referimin të shërbimeve shëndetësore dhe sociale bazë. (OCDE, 2020)

Në 11 mars 2020 OBSH deklaroi sëmundjen e korona virusit si pandemi globale. Institucionet e edukimit të lartë anë e mbanë botës menjëherë kaluan në kurse online me qëllim që të minimizojnë infektimet me COVID-19. Termi “pedagogji pandemike” u krijua shpejt teksa edukatorët mundoheshin të gjenin forma efektive të mësimdhënies online teksa mbanin distancë sociale dhe kujdeseshin për familjet e tyre në shtëpi. (Ebner, 2020)

Pandemia e COVID-19 ka pasur impakte dramatike anë e këndë botës, këto efekte të saj kanë ndikuar në mënyrë shumë drastike dhe tragjike për njerëzimin. Ndër këto pasoja ka qenë edhe izolimi i popullatës, për disa ky izolim ka qenë shkatërrues kurse për të tjerët ka qenë i mikëpritur pasi që ka ulur dinamikën e jetës dhe u ka dhënë njerëzve një shancë për tu rilidhur me aspekte të jetës që dukeshin që pa arritshme më parë. Për shumë individ të përfshirë me edukimin ambiental dhe në përdorimin e metodave pandemia ka qenë veçanarisht e vështirë, me mbylljet që nënkuptonin që programet do duhej të anuloheshin, dhe në disa vende këto mbyllje vazhdojnë akoma. (Botwrore, 2020)

KAPITULLI II

Qëllimi i hulumtimit

Mësimdhënia dhe të nxënit, si proces i gjatë edukativ, përmes të cilit kalojnë të gjithë individët e shoqërisë botërore, ka për qëllim t'i përshtatet dhe të bëjë gjetje për të nxënit gjithëpërfshirës, pasi njerëzit mësojnë në mënyra të ndryshme. Disa nxënës duan të shohin materialin të cilin mësojnë, të tjerë e kanë më mirë ta marrin formacionin me të dëgjuar, disa duan të flasin dhe ta shoqërojnë edhe me emocione etj.

Por përkundër benefiteve problemi qëndron në faktin që këto metoda nuk përdoren aq sa duhet në shkollat tona përfshirë edhe komunën e Ferizajt, mësimdhënësit preferojnë të përdorin teknika të mësimdhënies të cilat janë tradicionale dhe jo efektive, d.m.th nuk e përdorin teknologjinë.

Qëllimi i këtij hulumtimi është të tregojë se sa përdoren metodat efektive nga mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat e mesme të ulta në komunën e Ferizajt dhe cilat janë arsyet e përdorimit apo të mospërdorimit të këtyre metodave.

PYETJE E HULUMTIMIT

1. Sa aplikohet përdorimi i metodave efektive nga mësimdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe në shkollat fillore të mesme të ulta në komunën e Ferizajt?

PYETJE NDIHMËSE HULUMTUESE:

2. Sa ndikon mosha e mësimdhënësve dhe përvoja e tyre në përdorimin e metodave efektive?
3. Cilat janë përparsitë e përdorimit të metodave efektive në mësimdhënie?
4. Cilët janë faktorët kufizues që pengojnë përdorimin e metodave efektive në mësimdhënie?

HIPOTEZA

Mësimdhënësit e shkollave të mesme të ulta në komunën e Ferizajt nuk përdorin metoda efektive në mësimdhënien e gjuhës dhe letërsisë shqipe.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky hulumtim u zhvillua me mësime të lëndës së Gjuhës dhe letërsisë shqipe, në shkollat e mesme të ulta, të komunës së Ferizajt. Numri i mësimeve që ishin pjesë e mostrës është 60. Mbledhja e të dhënave për këtë hulumtim u bë përmes teknikës së anketimit (sondazhit).

Instrument i hulumtimit është pyetësi i mbyllur dhe të dhënat e nxjerra nga pyetësi janë të standardizuara, ndërsa metoda e përdorur është metoda kuantitative (sasiore).

“Metoda sasiore e hulumtimit merret kryesisht me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave që janë të strukturuar dhe mund të paraqiten në forma numerike, si dhe mund të analizohen nga ana statistikore.” (Matthews & Ross, 2010)

Mbledhja e të dhënave për shkak të pandemisë u bë në mënyrë virtuale (online), përmes emaileve dhe sondazhit të postuar në rrjete sociale (Facebook) ku mësimeve plotësuan pyetësin me opsionin më të përshtatshëm për ta.


Mësimeve duke iu përgjigjur pyetësit të parashtruar, kanë treguar: *Sa i përdorin metodat efektive në mësime, arsyet pse i përdorin apo pse nuk i përdorin ato dhe si e organizojnë një orë duke i përdorur këto metoda.* Ky hulumtim synon të kontribuojë në të kuptuarit se sa përdoren metodat efektive në mësime, si dhe se sa është i rëndësishëm përdorimi i tyre për nxënësit në komunën e Ferizajt.

Mostra

Si mostër e këtij hulumtimi janë marrë 60 mësime të shkollave të mesme të ulta të komunës së Ferizajt prej të cilëve 43 ishin femra dhe 17 meshkuj, 39 mësime ishin ushtrues detyre në shkolla rurale dhe 21 mësime japin mësim në shkollat urbane.


Tabela 1: Karakteristikat përshkruese të mostrës, gjinia dhe vendbanimi i tyre.

Gjinia:	Numri:	Përqindja:	Vendbanimi:	Numri:	Përqindja:
Femër:	43	72%	Rural	39	65%
Mashkull:	17	28%	Urban	21	35%
Gjithsej	60	100%		60	100%




Grafiku 1: Lokacioni i shkollës ku japin mësim mësimdhënësit e anketuar.

Nga të gjithë mësimdhënësit e anketuar 39 ose 65% e tyre ishin mësimdhënës të shkollave rurale kurse vetëm 21 (35%) janë mësimdhënës në shkollat urbane të komunës së Ferizajt. Vlenë të cekët gjithashtu se numri i shkollave rurale është dukshëm më i madh se shkollat urbane. Gjithsej janë 39 shkolla rurale në komunë kurse vetëm 8 shkolla urbane, kjo një arsye që e afekton shpërndarjen distributive të numrit të mësimdhënësve në këtë aspekt.




Grafiku 2: Gjinia e mësimeve të mësuesve të anketuar.

Prej të dhënave të nxjerra nga të anketuarit në hulumtim arrihet të kuptohet që shkollat e komunës së Ferizajt dominohen nga mësimeve të gjinisë femërore për lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe me gjithsej 43 femra ose 72% dhe vetëm 17 meshkuj ose 28% e stafit.



Grafiku 3: Moshë e mësimeve të anketuar.

Në aspektin e moshës mësimeve biologjike të Komunës së Ferizajt dominohen nga moshë më e vjetër ku 65% e të gjithë mësimeve ishin të moshës 41-65 vjet. 21 mësimeve ose 35% ishin të moshës 51-65 vjetare, 18 mësimeve (30%) i përkisnin moshës 41-50 vjet, 11 mësimeve (18%) ishin të moshës 31-40 dhe vetëm 10 mësimeve (17%) ishin të moshës 20-30.



Grafiku 4: Përgatitja profesionale e mësimeve të mesme të ulta.

Në aspektin e përgatitjes profesionale shumica e mësimeve të mesme të ulta kanë të përfunduar Fakultetin e Edukimit Bachelor në Gjuhë shqipe gjithsej 40% e tyre ose 24 mësime të mesme të ulta. Kurse pjesa tjetër 14 individ (23%) kanë të përfunduar fakultetin e Filologjisë drejtimi Bachelor i Gjuhës shqipe. Vetëm 7 mësime të mesme të ulta (12%) kanë të përfunduar masterin e mësimeve të mesme të ulta në Gjuhë dhe letërsi shqipe. Në anën tjetër 4 mësime të mesme të ulta (7%) kanë të përfunduar masterin e Gjuhës shqipe ne Filologji dhe 11 mësime të mesme të ulta (18%) kanë kryer fakultete tjera.

Instrumentet

Mbledhja e të dhënave në këtë hulumtim është bërë me anë të pyetsorit i cili ka qenë i formuluar nga pyetje të mbyllura (me opsione) si dhe rezultatet e dalura nga hulumtimi janë të dhëna të standardizuara.

Procedurat

Hulumtimi është realizuar në IV faza:

Faza e I-rë përfshinë analizën teorike të shqyrtimit të literaturës shkencore, hulumtimet e mëparshme në lidhje me përdorimin e metodave efektive në mësimdhënie në shkolla botërore ose vendore dhe analizimin më të thellë të teorive të autorëve të ndryshëm në çështjen e shtjelluar në hulumtim.

Faza e II-të përfshinë hulumtimin aktiv me mësimdhënës duke përzgjedhur mostrën pastaj përgatitja e pyetsorit me pyetje të përshtatshme lidhur me qëndrimet e tyre për aplikimin e të nxënit në natyrë.

Faza e III-të përfshinë përpunimin statistikor të të dhënave të mbledhura nga pyetsori, përpunimi e të dhënave fillon nga të dhënat e përgjithshme si gjinia, vendbanimi, mosha, përgatitja profesionale e mësimdhënësve, përvoja e tyre në mësimdhënie, etj., dhe vazhdon me pyetje specifike rreth qëndrimeve të tyre për çështje të caktuara.

Faza e IV-të e cila përfshinë analizën statistikore të rezultateve në formë tabelare dhe grafik për secilën përgjigje të ofruar nga të anketuarit. Si dhe krahasimet mes përgjigjeve të ndryshme ose mes karakterisitkave të mësimdhënësit dhe qëndrimeve të caktuara.


KAPITULLI IV

Analiza e të dhënave dhe rezultatet

Hulumtimi është realizuar me mësimdhënësit e Gjuhës shqipe në shkollat e mesme të ulta të komunës së Ferizajt. Në hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 60 mësimdhënës prej të cilëve 39 ishin mësimdhënës të shkollave rurale (fshatra) kurse 21 ishin mësimdhënës të shkollave urbane (qytete). Prej tyre femra ishin 43 kurse meshkuj ishin gjithësej 17 mësimdhënës.

Instrumenti i përdorur për mbledhjen e të dhënave ishte pyetësi i cili mbledhë të dhëna për përdorimin e metodave efektive nga mësimdhënësit e Gjuhës dhe letërsisë shqipe si dhe përparësitë dhe pengesat e kësaj metode në mësimdhënie.


Për çështjen e përdorimit të metodave efektive në krahasim me pozitën ku ndodhet shkolla (nëse është në vend rural apo urban) më detajisht është shqyrtuar në grafikun 5.



Grafiku 5: Krahasimi i përdorimit të metodave efektive në shkollat rurale në krahasim me ato urbane.

Siç shihet nga të dhënat e fituara nga grafiku 2 vendet urbane përdorimi i metodoave aplikohet nga 81% e mësimdhënësve (17 mësimdhënës nga 21 gjithsej preferojnë të përdorin metoda efektive si pjesë të mësimdhënies së tyre). Për dallim nga vendet rurale ku vetëm 56% e mësimdhënësve preferojnë të aplikojnë metoda efektive në orën e tyre mësimore (nga 39 mësimdhënës vetëm 22 e aplikojnë përdorimin e metodave efektive). Prej ku mund të konkludohet që përdorimi i metodoave efektive në vendet urbane është dukshëm më i lart se në vendet rurale.

Në aspektin e ndërlidhjes së moshës me përdorimin e metodave efektive më detajisht është shprehur në grafikun 6.



Grafiku 6: Ndërlidhja mes moshës së mësimit dhe të përdorimit të metodave efektive

Mosha e mësimit ka një efekt direkt në përdorimin e metodave efektive nga ai/ajo, meqenëse kjo metodë kërkon shumë energji dhe përkushtim.


90% e mësimit të moshës 20-30 vjeçare e aplikojnë përdorimin e metodave të ndryshme efektive.

Nga mësimit e moshës 31-40, 91% e tyre preferojnë këtë metodë.

56% e mësimit përdorin metoda efektive në mësimiten e tyre nga mësimit e grup moshës 41-50.

Kurse vetëm 48% e mësimit të grupmoshës 51-65 preferojnë të përfshijnë të përfshijnë metoda efektive në planprogramin e tyre mësimit.


Përmes këtij grafiku mund të vërehet që sa më e re moshë e mësimit aq më e lartë është përdorimi i metodave efektive në mësime.



Grafiku 7: Korrelacioni mes moshës së mësimit dhe përdorimit të metodave efektive në mësime

Korrelacioni i paraqitur në grafik mes moshës së mësimit dhe përdorimit të metodave efektive në natyrë tregon një ngritje eksponenciale të moshës së mësimit në raport me përdorimin e metodës së të nxënies në natyrë, këtu vërehet që me rritjen e moshës së mësimit bie niveli i përdorimit të metodave efektive në mësime. Gjithashtu korrelacioni mes këtyre dy vlerave shfaqet me vlerë 0.56 që paraqet një ngritje të moderueshme me lidhje pozitive.


Për përgjigjet rreth përvojës së mësimit në arsim detajet janë paraqitur në grafikun 8.



Grafiku 8: Përvoja e mësimit në fushën e edukimit.

Mësuesit e anketuar rangonin në përvoja të ndryshme vjeçare në mësimit. Numri më i madh i tyre 16 mësues ose 27% e tyre kanë përvojë mbi 20 vjeçare në mësimit. 11 mësues (18%) kanë përvojë 16-20 vjet. 11 mësues kanë përvojë 11-15 vjet kurse 22 mësues kishin përvojë prej 1 deri në 10 vjet.

Për çështjen e ndërlidhjes së përvojës së mësimdhënësve dhe përdorimit të metodave efektive më detajisht është paraqitur në grafikun 9.




Grafiku 9: Ndërlidhja mes përvojës së mësimdhënësit dhe përdorimit të metodave efektive.

Nga analizat e të dhënave është vërejtur një lidhje e dukshme mes përvojës së mësimdhënësit dhe përdorimit të metodave efektive. Nga grafiku mund të vërehet që sa më i ri të jetë mësimdhënësit që nënkupton sa më pak përvojë të ketë në mësimdhënie është më entuziast në përdorimin e metodave efektive. Mësimdhënësit që kanë nën 5 vjet përvojë preferojnë më shumë përdorimin e metodave efektive nga 9 individ 8 prej tyre aplikojnë metodat efektive.

Mësimdhënësit me përvojë 6-10 vjet nga 12 individ 10 prej tyre e preferojnë përdorimin e metodave efektive gjatë mësimdhënies së tyre.

Më rritjen e viteve të përvojës së mësimdhënësve ullet preferenca për aplikim të metodave efektive. Individët me përvojë 11-15 vjeçare nga 12 prej tyre vetëm 7 preferojnë të përdorin metoda efektive. Individët me përvojë 16-20 vjeçare prej 11 vetëm 6 preferojnë të përdorin metoda efektive kurse individët me përvojë mbi 20 vjeçare prej 16 individëve vetëm 8 preferojnë përdorjen e metodave efektive në mësimdhënie.


Për realizimin e orëve me metoda efektive një rol të veçantë në arritjen e këtij qëllimi ka edhe numri i nxënësve që gjenden në klasë. Përmes përgjigjeve të mësimitdhënësve është fituar pasqyrë e numrit të nxënësve në klasa në shkollat e hulumtuara të cilat janë paraqitur në grafikun 10.



Grafiku 10: Numri nxënësve në klasë.

Nga përgjigjet e ofruara nga mësimitdhënësit kuptohet që numri i nxënësve në klasa nuk është shumë i madh, 29 individ ose 48% e mësimitdhënësve njoftuan që numri i nxënësve në klasat e tyre është rreth 21-30 nxënës, 20 arsimtar ose 33% pohuan të kenë vetëm 10-20 nxënës në klasa kurse vetëm 11 arsimtar (18%) pohuan që kanë klasa me numër të nxënësve 31-40.

Përdorimi i metodave efektive nga mësuesit si pjesë e planit të tyre mësimor, dallon nga mësuesi në mësues andaj grafiku 11 jep detaje për pyetjen se a përdorin metoda efektive mësuesit në mësuesien e tyre.




Grafiku 11: Sa përdorin metoda efektive në mësuesien.

Nga gjithsej 60 mësues të anketuar 39 ose 65% prej tyre pohuan që përdorin metoda efektive si formë të mësuesies së tyre kurse 21 mësues ose 35% deklaruan që nuk e preferojnë të aplikojnë këtë metodë në procesin mësimor të tyre.

Nga grafiku mund të përfundohet që metodat efektive aplikohen nga një numër i madh i mësuesve në shkollat ku është kryer hulumtimi.

Mësuesve që pohuan se përdorin metoda efektive gjatë mësuesies së tyre i'u parashtruan edhe disa pyetje rreth mënyrës së si e aplikojnë dhe sa e aplikojnë këtë metodë në mësuesien e tyre.

Përdorimi i metodave efektive janë shumë të rëndësishme për zhvillimit e njësive mësimore dhe mësimdhënie efektive, andaj për këtë çështje detajet e përgjigjeve të marra nga mësimdhënësit janë paraqitur në grafikun 12.




Grafiku 12: Sa orë mësimore mësimdhënësit i'a kushtojnë metodave efektive.

Nga 39 mësimdhënës që pohuan në aplikimin e metodave efektive, në pyetjen se sa orë vjetore i'a kushtojnë kësaj metode 18 mësimdhënës ose 46% deklaruan që i'a kushtojnë 1-5 orë mësimore, 9 mësimdhënës ose 23% pohuan që i'a kushtojnë 6-10 orë, 6 mësimdhënës informuan që i'a kushtojnë 11-15 orë, 2 mësimdhënës pohuan që i'a kushtojnë 16-20 orë kurse vetëm 3 mësimdhënës njoftuan t'i kushtojnë përdorimit të metodave efektive mbi 20 orë.

Nga grafiku i lartpërmendur mund të konkludohet që shumica e mësimdhënësve i kushtojnë 1-5 orë mësimore përdorimit të metodave efektive gjatë një viti shkollor.

Planifikimi i orëve mësimore mund të bëhet në forma të ndryshme, grafiku në vijim jep detaje për formën e planifikimit që përdorin më shumë mësime dhënësit e shkollave ku është kryer hulumtimi.




Grafiku 13: Cka përdorin mësime dhënësit për planifikimin e një ore mësimore.

Në pyetjen se si e bëjnë planifikimin e një ore mësimore shumica e mësime dhënësitve përkatësisht 20 prej tyre ose 51% pohuan që bashkëpunojnë me kolegët e tyre rreth planifikimit. Kurse grupi tjerët prej 16 arsimtarëve ose 41% deklaruan që e vetëplanifikojnë një orë të tillë mësimore. Vetëm 3 mësime dhënësit ose 8% informuan që planin e mbajtjes së një ore mësimore e marrin nga interneti.

Grafiku 13 përveç se tregon që mësime dhënësit preferojnë të planifikojnë orët mësimore në bashkëpunim me kolegët e tyre, kjo nënkupton gjithashtu edhe bashkëpunim të shëndosh mes mësime dhënësitve me njëri-tjetrin në të mirë të nxënësve.

Orët me përdorimin e metodave efektive paraqesin një problem në vetëvete për planifikimin e tyre, andaj detaje rreth vështirësisë së planifikimit të këtyre orëve për shkollat e hulumtuara janë dhënë në grafikun 14.




Grafiku 14: Niveli i vështirësisë së planifikimit të orëve me metoda efektive.

Në pyetjen rreth vështirësisë së planifikimit të orëve me metoda efektive shumica e mësimitdhënësve anojnë në opsionin për vështirësi në organizim ku 15 mësimitdhënës ose 38% njoftuan që planifikimi i orëve me metoda efektive është mesatarisht i vështirë kurse 14 mësimitdhënës ose 36% pohuan që planifikimi është shumë i vështirë. Vetëm 9 mësimitdhënës e cilësuan planifikimin e këtij aktiviteti si pak ose aspak të vështirë për ta.

Sipas mësimitdhënësve të anketuar planifikimi i orëve me përdorim të metodave është mesatarisht i vështirë dhe anon nga e vështira, çka nënkupton që planifikimi i një ore të tillë kërkon nga mësimitdhënësi të ketë aftësi të mira menaxhuese dhe organizuese.

Për çështjen e efektit pozitiv që ka përdorimi i metodave efektive në mbajtjen mend të koncepteve nga ana e nxënësve detaje janë dhënë në grafikun 15.




Grafiku 15: Niveli i ndikimit pozitiv të përdorimit të metodave efektive në mësimnxënien e koncepteve.

Për sa i përketë efektit pozitiv që paraqet përdorimi i metodave në të mbajturit mend të koncepteve nga ana e nxënësve në krahasim me orët e mbajtura në mënyrë tradicionale 32 mësimdhënës ose 82% pajtohen me këtë pohim kurse vetëm 7 (18%) deklaruan që kanë vërejtur pak ndryshim në mbajtjen mend.

Si konkludim mund të arrihet që përdorimi i metodave ka një efekt shumë të madh pozitiv në mbajtjen mend të koncepteve nga nxënësit sipas mësimdhënësve të anketuar.


Për nxitsin kryesorë për zhvillimin e orëve me metoda efektive, mësimehdhënësit e anketuar dhanë ide të ndryshme të cilat më detajisht janë paraqitur në grafikun 16.



Grafiku 16: Nxiti më i madhë për realizimin e orëve me metoda efektive.

Sipas mësimehdhënësve të anketuar nxiti kryesorë në mbajtjen e orëve me metoda efektive për mësimehdhënësit është: “Forma e mësimit më atraktive dhe më interesante” ku 28 mësimehdhënës ose 47% e pjesëmarrësve anojnë në këtë drejtim, shtytësi tjetër dominues është edhe interesimi dhe entuziazmi i nxënësve për orë të tilla pohim që mbështetet nga 20 mësimehdhënës ose 33%, dhe 11 mësimehdhënës të tjerë deklarojnë që shkaktar është ndririmi i monotonisë së klasës.


Përdorimi i metodave efektive ka rëndësinë e vetë në zhvillimin personal dhe akademik të nxënësve, detaje rreth kësaj rëndësie jepen në grafikun 17.



Grafiku 17: Niveli i rëndësisë së metodave efektive në zhvillimin personal dhe akademik të nxënësit.

Në pyetjen se sa e konsiderojnë të rëndësishme përdorimin e metodave për zhvillimin personal dhe akademik të nxënësit, mësimdhënësit në një grup të madh prej 42 mësimdhënës ose 70% e konsiderojnë si shumë të rëndësishme kurse vetëm 4 mësimdhënës ose 7% nuk e konsiderojnë të rëndësishme këtë aktivitet


Mendimet e mësimeve të anketuar për rëndësinë e përdorimit të metodave efektive janë dokumentuar në grafikun 18.



Grafiku 18: Mendimet e mësimeve për rëndësinë e përdorimit të metodave efektive si pjesë e mësimit.

Mësimeve të anketuar e cilësojnë përdorimin e metodave efektive si pjesë të rëndësishme të mësimit ku 45 mësimeve ose 75% e tyre pohuan në këtë deklaratë kurse vetëm 4 mësimeve 7% nuk u pajtohan me këtë qëndrim.


Qëndrimet e mësimeve të shkollave pjesëmarrëse në hulumtim rreth mendimit të tyre nëse përdorimi i metodave efektive duhet të jetë obligative me kurrikulë janë paraqitur në grafikun 19.



Grafiku 19: Mendimet e mësimeve të shkollave pjesëmarrëse.

Në pyetjen se a mendoni që mbajtja e orëve mësimore me metoda efektive duhet të jetë obligative me kurrikulë 48% e mësimeve të shkollave pjesëmarrëse ose 29 individ mendojnë që duhen të obligohen përmes kurrikulës dhe të mbahen për të gjithë nxënësit, në të gjitha shkollat e vendit. Kurse 16 mësime të shkollave pjesëmarrëse ose 27% mendojnë të kundërtën dhe 15 mësime të shkollave pjesëmarrëse nuk kanë shprehur ndonjë mendim.

Për problemin nëse kurrikula e Kosovës ofron udhëzime për zhvillimin e orëve me metoda efektive, detaje të saj ofrohen në grafikun 20.




Grafiku 20: Pohimet e mësimeve në ofrimin e udhëzimeve nga kurrikula e Kosovës për zhvillimin e orëve me metoda efektive.

Në pyetjen se a ofron Kurrikula e Kosovës udhëzime për mbajtjen e orëve me metoda efektive 62% ose 37 mësimeve u përgjigjën me “jo” kurse vetëm 4 mësimeve (7%) deklaruan që “po” kurse pjesa tjetër prej 19 mësimeve (32%) nuk ishin në dijeni nëse kurrikula e Kosovës ofron udhëzime ose jo.

Përfundimisht shumica e mësimeve mendojnë që kurrikula e Kosovës nuk ofron udhëzime për zhvillimin e orëve me metoda efektive dhe se ata duhet të improvizojnë.

Sigurimi i mjeteve financiare për zhvillimin e orëve me metoda efektive është njëra ndër pengesat kryesore për zhvillimin e orëve të tilla. Për çështjen nëse ky financim do duhej të sigurohej nga DKA ose Ministria e Arsimit mësimdhënësit e anketuar kanë dhënë mendimet e tyre të cilat më detajisht janë paraqitur në grafikun 21.




Grafiku 21: Mendimet e mësimdhënëve për financimin e orëve me metoda efektive nga DKA ose Ministria e Arsimit.

Për çështjen nëse orët e mësimit me metoda efektive do duhej të financoheshin nga DKA ose ministria e arsimit 44 mësimdhënëses ose 73% e mbështesin këtë qëndrim vetëm 9 mësimdhënëses ose 15% nuk mendojnë që DKA ose Ministria e Arsimit do duhet të mbështesë financiarisht orët me metoda efektive.

Si përfundim mësimdhënësit me një shumicë bindëse mendojnë që ky problem financiar do duhej të zgjidhej nga organet organizuese të arsimit siç janë: DKA ose dhe Ministria e Arsimit.

Për pyetjen se sa e preferojnë përdorimin e metodave efektive si pjesë të mësimdhënies së tyre, mësimdhënësit e anketuar kanë shprehur mendimet e tyre të cilat detajisht janë shprehur në grafikun 22.




Grafiku 22: Mendimet e mësimdhënësve rreth preferencës së tyre për përdorimin e metodave efektive në lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe.

Në çështjen rreth preferencës së mësimdhënësve të anketuar janë të ndarë në dy grupe, në atë që sa e pëlqejnë përdorimin e metodave efektive, 39 mësimdhënës ose 50% e tyre e preferojnë shumë këtë metodë në mësimdhënien e tyre, kurse 22 mësimdhënës ose 35% e pëlqejnë pak ose aspak kurse 8 mësimdhënës janë neutral në këtë pyetje.

Prej mësimdhënësve të shkollave të hulumtuara një shumicë e tyre e preferojnë përdorimin e metodave efektive në lëndën e Gjuhës dhe letërsisë shqipe.


Përdorimi i metodave efektive ka benefitet e veta në krahasim me të nxënit tradicional në klasa. Për këto benefite mësime të pjesëmarrës në hulumtim kanë dhënë mendimet e tyre të cilat janë shprehur në grafikun 23.



Grafiku 23: Përfitimet e nxënësve nga mësimeve me metoda efektive në krahasim me mësime tradicionale në klasa.

Sipas mësimeve të anketuar përfitimet më të mëdha që kanë nxënësit nga realizimi i orëve me metoda të ndryshme efektive janë: “E bënë orën mësimore më atraktive” që është njëra ndër deklaratat më të pranuar nga 29 mësime të pastaj “Lidhë teorinë shkollore me observimin në natyrë” mendim i shprehur nga 27 mësime, “Rrit interesimin e nxënësve për mësim” vlerësuar nga 26 mësime, “Lidhë jetën e shkollës me jetën jashtë shkolle” dhe “Nxitë të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësve” mendime të shprehura nga 22 mësime të anketuar. Këto janë deklaratat që mbizotrojnë nga të tjerat dhe paraqesin përfitimet kryesore që kanë nxënësit nga të mësuarit me metoda efektive sipas mësimeve.


Pandemia e dy viteve të fundit ka ndikuar në ç’do aspekt të jetës përfshirë edhe arsimin e në veçanti zhvillimin e orëve me metoda efektive. Mësimdhënësit e anketuar kanë shprehur mendimet e tyre rreth ndikimit të pandemisë në mësim, mendimet e tyre më detajisht janë shprehur në grafikun 24.



Grafiku 24: Mendimet e mësimdhënësve në ndikimin e pandemisë në mbajtjen e orëve mësimore.

Për ndikimin e pandemisë në të nxënit me metoda pajtohen shumica e mësimdhënësve ku gjithsej 44 prej tyre ose 73% mendojnë që pandemia ka ndikuar shumë në këtë aspekt të mësimdhënies vetëm 10 mësimdhënës ose 17% nuk mendojnë që ka pasur ndonjë efekt në të.

Mënyra më e lehtë e përdorimit të metodave efektive është teknologjia. Rreth përdorimit të teknologjisë nga mësime dhënësit e anketuar detajet e saj janë paraqitur në grafikun 25.




Grafiku 25: Niveli i përdorimit të teknologjisë nga mësime dhënësit për mbajtjen e orëve mësimore.

Në pyetjen se sa e përdorin teknologjinë mësime dhënësit e anketuar shumica e tyre 25 mësime dhënëse ose 42% deklaruan që e përdorin mesatarisht teknologjinë, 20 mësime dhënëse ose 33% pohuan që e përdorin pak ose aspak kurse 15 mësime dhënëse ose 25% deklaruan që e përdorin shumë teknologjinë.

Edhe pse është forma më e lehtë për zhvillimin e orëve me teknologji dhe nuk kërkon leje të veçant ose shpenzime shtesë.


Në grafikun e mësipërm u deklarua që mësime të ndërlidhjes mes vendndodhjes së shkollës dhe përdorimit të teknologjisë shqyrtohet në grafikun 26.



Grafiku 26: Ndërlidhja mes vendndodhjes së shkollës dhe përdorimit të teknologjisë për të nxënësit.

Përmes krahasimit të të dhënave të ofruara për përdorimin e teknologjisë dhe lokacionit të shkollës u kuptua që teknologjia shfrytëzohet më shumë në shkollat urbane sesa në shkollat rurale. 12 mësime të shkollave urbane e përdorin shumë teknologjinë, 19 mësime të shkollave rurale e përdorin mesatarisht kurse vetëm 8 mësime të shkollave rurale e përdorin pak. Për dallim nga shkollat rurale ku 3 mësime të shkollave urbane e përdorin shumë teknologjinë, 10 mësime të shkollave urbane e përdorin pak kurse 6 mësime të shkollave rurale e përdorin mesatarisht dhe 2 prej tyre nuk e përdorin aspak. Ky grafik tregon një ndërlidhje të fortë mes përdorimit të teknologjisë.

Gjatë zhvillimit të një ore me metoda efektive mund të shfaqen shumë probleme të cilat pastaj e pengojn organizmin e një ore të tillë. Mësimdhënësit pjesëmarrës në hulumtim kanë listuar disa nga arsyt kryesore që i pengojnë për zhvillimin e orëve me metoda efektive të cilat janë paraqitur në grafikun 27.




Grafiku 27: Pengesat kryesore që shfaqen në mbajtjen e orëve me metoda efektive.

Gjatë mbajtjeve të orëve me metoda efektive paraqiten pengesa të ndryshme, sipas mësimdhënësve pengesat kryesore që i'a vështirësojnë mbajtjen e orëve me metoda efektive janë: “Mungesa e materialeve, teknologjisë” ku 18 (30%) mësimdhënës e mbështesin këtë deklarat si dhe “Kostoja e tyre” që mbështetet nga 15 (25%) mësimdhënës. Këto dy deklarat janë më të pranuarat që pastaj shoqërohen nga “Klasat e mëdha” e mbështetur nga 10 mësimdhënës (17%), “Oraret e ngjeshura dhe vështirsia e menaxhimit të orës” e mbështetur nga 8 mësimdhënës (13%) si dhe pengesa nga DKA ose drejtoria e shkollës me 2%.

Arsyeja kryesore që mësimdhënësit hezitojnë të zhvillojnë orë me metoda efektive janë mungesa e materialeve dhe kostoja e tyre.

Për zhvillimin e orëve me metoda efektive, mësime dhënësi duhet të ketë aftësi të mira menaxhese dhe organizuese të cilat mund të mësohen gjatë trajnimeve të ndryshme. Në grafikun 28 mësime dhënësit e anketuar deklarojnë rreth trajnimeve që kanë mbajtur për përdorimin e metodave efektive.




Grafiku 28: Numri i trajnimeve të ndjekura nga mësime dhënësit për mbajtjen e orëve me metoda efektive.

Sa i përket numrit të trajnimeve të ndjekura nga mësime dhënësit për mbajtjen e orëve me metoda efektive një numër i madh i tyre prej 41 mësime dhënësit ose 68% nuk kanë ndjekur kurrë trajnime të tilla.

14 mësime dhënësit ose 23% gjatë kohës së tyre në mësime dhënësit kanë ndjekur 1-3 trajnime për të përdorur metoda efektive. 4 mësime dhënësit kanë ndjekur 4-6 trajnime kurse vetëm 1 mësime dhënësit u deklarua se ka ndjekur mbi 10 trajnime.

Numri dërmues i mësime dhënësitve pjesëmarrës në hulumtim deklaruan që nuk kanë ndjekur asnjëherë trajnime për përdorim të metodave efektive.

Nga grafiku i lartpërmendur kuptohet që shumica e mësimeve nuk kanë ndjekur asnjëherë trajnime për përdorim të metodave efektive, por detaje rreth qasjes së tyre nëse janë të gatshëm të marrin pjesë në trajnime të tilla nëse organizohen ofrohen në grafikun 29.



Grafiku 29: Gatishmëria e mësimeve në pjesëmarrje në trajnime për mbajtjen e orëve me metoda efektive.

Mësimeve të anketuar kanë shprehur një gatishmëri shumë të madhe për pjesëmarrje në trajnime nga 60 të anketuar 49 mësimeve ose 82% janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen nëse do merrnin pjesë në trajnime për organizimin e orëve me metoda efektive. 8 mësimeve u përgjigjen negativisht dhe 3 të tjerë ishin neutral në këtë pyetje.

KAPITULLI V

Diskutimi

Në ditët e sotme të zhvillimit të shoqërisë dhe rritjes me ritme të shpejta të teknologjisë, procesi i mësimdhënies është kompleks dhe për ta thjeshtësuar këtë proces duhet përdorur metoda sa më efikase gjatë punës me nxënës.

Historikisht metodat mësimore kanë evoluuar, kanë ndryshuar, janë përsosur e modernizuar në përputhje me zhvillimet shoqërore, ekonomike dhe politike. Ndaj, mësimdhënia duhet të jetë e menduar mire, por dhe e planifikuar mirë. Metodatat e mësimdhënies janë ecuri organizative me anë të të cilave mësuesi përpiqet të realizojë nivelin e dëshiruar të të nxënës dhe objektivat lëndore.

“Të përpiqesh të dallosh mes metodave të të mësuarit se cila është më e mira është po aq e kot sa të përpiqesh të dallosh se cili është më i vlefshëm, të ecurit apo të notuarit. Të notuarit të duhet kur je në det dhe të ecurit për në tokë. Pra e thënë ndryshe nuk është një metodë e caktuar ajo që sjell suksesin në klasë, por një kompleks metodash. Të gjitha metodat, teknikat dhe strategjitë e të mësuarit, secila me specifikat e saj, vlejné për të realizuar qëllime të caktuara të orës mësimore”- Robert Stavins (Stavins, 2019)

Një rang i hulumtimeve të kryera nga shkenctarë të ndryshëm kanë treguar që avantazhet e përdorimit të metodave efektive në mësimdhënie janë: Inkurajimi i nxënësve të zgjidhin problemet, të lidhen, të japin përparësi dhe të përfshijnë njohuri konceptuale, zhvillimi i qëndrimeve dhe vlerave, promovimi i përvojave sociale dhe intelektuale, zhvillimi i aftësive të prezantimit, zhvillimi i mendimit kritik etj.

Nga të dhënat e nxerra nga hulumtimi kuptohet që mësimdhënësit e konsiderojné shumë të rëndësishme përdorimin e metodave si pjesë të mësimdhënies, sipas tyre përdorimi i metodave ka përfitime shumë të mëdha nga ana e nxënësve, ata pajtohen që ora është shumë më atraktive me metoda të ndryshme, sesa ora që zhvillohet në mënyrë tradicionale, gjithashtu nxënësit kanë interesim më të madhë për njësinë mësimore që zhvillohet gjatë përdorimit të metodave çka nxitë te ta të menduarit kritik dhe kreativ. Sipas mësimdhënësve si përparsi tjetër është edhe ndërlihdja e jetës shkollore me jetën jashtë saj si dhe lidhja e teorisë me observimin praktikë e cila është e vërtetuar që zhvillon aftësitë kognitive, afektive dhe motorike si dhe zhvillon në aspektin personal dhe akademik të nxënësve (Grafiku 17,18,22 dhe 23). Këto janë edhe ndër arsyt kryesore që i nxitë mësimdhënësi të organizojné orë me përdorim të metodave efektive (Grafiku 16).

Sipas një studimi tjetër të kryer në Turqi të mësuarit me metoda në shkolla fillore dhe të mesme të ulta ndikon që efektiviteti i kësaj metode varet nga dizajnimi i mirë i një plani të saj, i cili duhet të përfshihet në kurrikulat shkollore. (YOKUS, 2020)

Mendim të njejt kanë edhe mësimdhënësit e komunës së Ferizajt sipas tyre orët me metoda efektive do duhej të jenë obligative me kurrikulë vendore dhe të praktikohet në të gjitha shkollat e vendit (Grafiku 19). Në anën tjetër të medaljes, përkundër përfitimeve që kanë nxënësit prej të nxënës në bazë të këtyre metodave kjo formë e mësimdhënies ka barrierat e veta. Shumë studime kanë

dokumentuar një numër të madh barrierash institucionale, kulturore dhe logjike që kanë limituar sasinë dhe përdorimin e metodave në klase që përfshijnë, mungesa e materialeve, mungesa e teknologjisë, vetëbesimi dhe eksperiencia e mësimit në aplikimin e këtyre metodave, kërkesat e kurrikulave shkollore, numri i madh i nxënësve nëpër klasa etj. Pengesa të tilla kanë pranuar që janë prezente në shkolla edhe mësimit pjesëmarrës në hulumtim. Sipas tyre barrierat kryesore që pengojnë përdorimin e metodave është kostoja dhe problemi i sigurtimit të të ardhurave për organizmin e aktiviteteve të tilla për të cilën shumica e mësimit mendojnë që do duhej të financohej nga DKA ose nga ministria e arsimit, kurse sa i përket numrit të nxënësve mësimit thonë që nuk paraqet problem të madh pasi që shumica e klasëve përmbanin numër të vogël të nxënësve 21-30 nxënës (Grafiku 21, 10 dhe 27). Nga ana tjetër hulumtimi im ka nxjerrë në pah që mësimit në komunën e Ferizajt përdorin mesatarisht metoda të ndryshme në mësimit dhe efektive (Grafiku 25). Dhe duke i krahasuar shkollat rurale me shkollat urbane në përdorimin e metodave efektive kuptohet që mësimit e shkollave rurale i përdorin më pak këto metoda, kurse shkollat urbane më shumë, kjo për shkak se në qytete shkollat janë më shumë të furnizuara me mjete të teknologjisë (Grafiku 26). Nga ana tjetër mësimit e shkollave urbane dukshëm më shumë përdorin metoda efektive si formë të mësimit së tyre sesa mësimit e shkollave rurale (Grafiku 20)

Përdorimi i metodave efektive aplikohet nga 65% e të anketuarve dhe ka ndërlidhje me moshën dhe përvojën e mësimit, ku mësimit e ri në moshë aplikojnë metodat efektive më shumë dhe me rritjen e moshës së mësimit bie tendenca e të aplikuarit të këtyre metodave (Grafiku 11 dhe 5). E njëjta është edhe me përvojën e tyre. Mësimit me më pak përvojë aplikojnë këtë metodë më shumë se mësimit me më shumë përvojë në mësimit (Grafiku 9). Këto dy grafike (5 dhe 8) e mbështesin njëra tjetrën.

Gjatë këtyre dy viteve të fundit sfidat e të mësimit sidomos në ambiente jashtë shkolle janë shfaqur dukshëm edhe nga pandemia Covid-19. Praktika edukative e të mësimit në është ndikuar shumë nga pandemia pasi që janë bërë kufizime në vende, në kontakte sociale etj. Diçka e tillë theksohet edhe nga mësimit e anketuar në hulumtim të cilët e kanë vë në pah ndikimin e madhë që ka pasur pandemia e COVID-it në të mësimit, në aspektin negativ (Grafiku 24).

Konkludimet

Konkludimet e arritura në përfundim të këtij hulumtimi janë:

- Në shkollat e mesme të ulta të komunës së Ferizajt mësimdhënësit e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe 72% prej tyre janë femra për dallim nga 28% të cilët janë meshkuj, gjithashtu dominojnë mësimdhënësit e moshave 41 deri në 65 vjeçare në krahasim me moshat më të reja prej moshës 20 vjeçare e tutje.
- Shumica e mësimdhënësve të gjuhës dhe letërsisë shqipe rreth 40% prej tyre kanë të përfunduar shkollimin bachelor dhe vetëm një numër i vogël i tyre prej 12% kanë të përfunduar masterin për mësimdhënie, pjesa tjetër e tyre kanë të përfunduar fakultete tjera.
- Meqenëse nga të anketuarit dominohet moshja e vjetër njëashtu dominohet edhe nga mësimdhënësit me më shumë përvojë në mësimdhënie nga 16 vjet deri në mbi 20 vjet përvojë pune.
- Në kundërshtim me hipotezën e parashtruar në fillim të hulumtimit nga të dhënat shihet që 65% e mësimdhënësve të anketuar përdorin metoda efektive në mësimdhënien e tyre dhe 35% e tyre nuk i përdorin ato. Ky përfundim hedh poshtë hipotezën që mësimdhënësit e gjuhë dhe letërsisë shqipe së komunës së Ferizajt nuk përdorin metoda efektive.
- Nga mësimdhënësit të cilët i përdorin këto metoda, shumica e tyre i'a kushtojnë 1 deri në 5 orë mësimore këtij aktiviteti, ata pranojnë që orët janë vështirë të planifikohen dhe se zakonisht ata i planifikojnë me anë të ndihmës së kolegëve të tyre të punës çka indikon bashkëpunim të shëndoshë mes mësimdhënësve të shkollave tona.
- Orët me metoda efektive duhen të jenë obligative në kurrikulën tonë shkollore dhe se ajo duhet të ofrojë udhëzime për organizmin e këtyre orëve.
- Përfitimet kryesore që ofron përdorimi i metodave janë: bënë orën atraktive; zhvillon aftësitë për jetë; lidhë jetën e shkollës me jetën jashtë shkolle; lidhë teorinë shkollore me observimin në natyrë; nxit mendim kritik dhe kreativ të nxënësve dhe zhvillon aftësitë motorike kognitive dhe afektive.
- Barrierat kryesore që pamundësojnë mbajtjen e orëve në natyrë janë: mungesa e mjeteve teknologjike, kostoja e tyre, menaxhimi i klasës dhe kohës, klasat e mëdha etj.
- Shumica e mësimdhënësve nuk kanë mbajtur asnjëherë trajnime për organizmin e orëve me metoda, por shumica janë të gatshëm të marrin pjesë në trajnime të tilla.

- Aplikimi i metodave efektive dukshëm më shumë praktikohet në shkollat urbane ku 81% e mësimitdhënësve të këto shkolla përdorin metoda efektive, kurse në krahasim me shkollat rurale vetëm 56% mësimitdhënës i përdorin këto metoda.
- Mësimitdhënësit e moshave më të reja dhe me më pak përvojë pune në arsim përdorin më shumë metoda efektive sesa mësimitdhënësit më të vjetër në moshë të cilët kanë edhe më shumë vite përvojë pune.

Kufizimet e hulumtimit

Meqenëse hulumtimi është zhvilluar gjatë pandemisë me virusin Korona, kjo ka kufizuar realizimin fizik të hulumtimit dhe kontaktit të drejtpërdrejt me mësimitdhënësit e cila nëse do realizohej fizikisht do shtonte mendime më të detajuara të mësimitdhënësve për çështjen që hulumtohet, duke ulur shkallën e probabilitetit për keqkuptime gjatë plotësimit të pyetësorit. Gjithashtu hulumtimi do ishte më i plotësuar nëse do përmbante edhe mendimet e nxënësve për përdorimin e metodave efektive në mësimitdhënie.

Hulumtimet në të ardhmen

Rezultatet e arritura nga ky hulumtim hapin rrugën për hulumtime të tjera të ngjashme më të detajuara dhe më gjithëpërfshirëse në të gjitha qytetet e Kosovës e jo vetëm në një qytet, gjithashtu hulumtimet e tilla mund të pasurohen edhe me mendimet e anës tjetër të medaljes që janë nxënësit se si ata e mendojnë rrealizimin e një ore mësimore me metoda efektive dhe ndikimin e saj në të nxënëit e tyre, të dhëna të cilat mund të krahasohen mes vete duke pasuruar dhe më tepër këtë fushë hulumtimi.

Implikimet praktike nga hulumtimi

Rezultatet e fituara nga ky hulumtim janë pasqyrë e praktikimit të metodave efektive nga mësimitdhënësit e gjuhës dhe letërsisë shqipe në komunën e Ferizajt. Përfundimet e arritura tregojnë që përkundër besimit që metodat efektive nuk aplikohen mjaftueshëm në mësimitdhënie, ajo aplikohet nga mësimitdhënësit sidomos në qytete dhe nga mësimitdhënësit më të rinjë në moshë.

Gjithashtu nga hulumtimi u vë në pah që të përdorimi i metodave ka një rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve, si në aspektin jetësor ashtu edhe intelektual. Por kjo formë e të mësuarit ka vështirësi në aplikim sipas mësimitdhënësve sepse nuk plotësohen kushtet e nevojshme.

Të dhënat e dala nga hulumtimi janë kontribut direkt në DKA-të e Kosovës sidomos në komunën e Ferizajt pasi që tregojnë qartë nga këndvështimi i mësimitdhënësve për rëndësinë e kësaj forme të mësimitdhënies si dhe si mund të kontribuojë kjo shtresë administrative e arsimit për lehtësimin dhe mundësimin e aplikimit të metodave efektive në shkolla.

REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

Tamo, A., Rapti, E., Karaj, Th.,(2005). "Mësimdhënia dhe të nxëniet", Shtëpia botuese "Mokra", Tiranë, Fq, 138-157.

Kazazi Nj., Garuci, N., Zhabjaku, N.,(2005). "Didaktikë e gjuhës shqipe", botim i ShBLU-së, Tiranë, Fq, 104-123.

MASH,(2011). "Metodat e mësimdhënies në arsimin fillor", Revista Mësuesi, Nr 9,Fq 18-29.

J.Thomai, V.Memisha, Pavli Haxhillari, Hjari Shehu, Artan Goga (2006). "Fjalor i gjuhës shqipe", Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.

Simon Pepa; Safet Hoxha; (1982). "Puna për ngulitjen e normës drejtshqiptimore", "Gjuha jonë", Tiranë, Fq 36-51,

Universiteti i Tiranës,(1982). "Metodika e gjuhës shqipe" (Maket), shtypur në Kombinatin Poligrafik, Tiranë, Fq.89-95

Musai, B, (1997). "Mjeshtëritë themelore të mësimdhënies", Tiranë, Fq, 41-66.

Memushaj, R., (2006). "Hyrje në gjuhësi", Toena,Fq, 123-138

Mehmet Celiku, Mahir Domi, Spiro Floqi, Seit MANSAKU, Remzi PËRNASKA, Stefan

PRIFTI, Menella TOTONI.(2002). "Gramatika e gjuhës shqipe" Vëllimi II, Tiranë, Fq. 112-134

Demiraj, Shaban (2002). "Gramatikë historike e gjuhës shqipe" Tiranë, Akademia e shkencave e Shqipërisë fq. 34-66

Rugova, Bardh (2015). "Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe", Trembelat Prishtinë, fq. 45-48

Klara Kodra, Rita Filipi, Stefan Capaliku(1999). "Letërsia Shqipe" Prishtinë, fq.68-75

Dodi, (1972). Drejtshqiptimi - Rreth problemeve të drejtshqiptimit të gjuhës letrare shqipe. SF fq. 56-67

Zeneli, I.,(2006). Bazat psikologjike të të nxëniet: Mekanizmat e funksionimit të mendjes. Prishtinë

Kadriu,Zeqir Fadil,Latifi (2015).Metodat bashkëkohore të mësimdhënies së gjuhës shqipe në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta. Konferenca "Java e shkencës".

BEP. (2013). Zhvillimi i shkathtësive të shekullit 21 në klasat me nxënësin në qendër.Prishtinë.

Botërore, B. (2020). Pandemia COVID-19: Goditjet ndaj Reagimeve të Arsimit dhe Politikës.

Maj. Fq.34-37.

Cheng, H.-F., & Zoltan Dornyei. (22 Dec 2008). *The use of Motivational Strategies in Language Instruction: The case of EFL teaching in Taiwan*. 153-174.

Kostallari, A., Lafe, E., Totoni, M., & Cikuli, N. (1984). *Gjuha letrare shqipe. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës*.

Likaj, E., & Çabej, M. (2010). *Morfologji e shqipes standarde. Tiranë: Julvin*.

MASHT. (2016). *Korniza e re e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së*

Kosovës. Prishtinë: Blendi. Fosnost. (1996). A psychological theory of Learning. New York.

Hungary, M. (2006). "101 Ide për mësimdhënës inovativ". Prishtinë

IZHA. (2014-2018). *Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat 6-7 -8 -9.*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2011). *Katalogu i programeve të akredituara për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe të udhëheqësve të arsimit. Prishtinë*

Kopnina, H. (2012). *Education for sustainable development (ESD): The turn away from "environment" in environmental education.*

MASHT. (2016). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës. Prishtinë.*

MASHT, S. (2012). *Udhëzues për përmirësimin e praktikave në klasë. Prishtinë*

Matthees, B., & Ross, L. (2010). *Research Methods, A partical guide for the social sciences. London: Pearson Education Limited 2010.*

Dhrimo, A., Angoni, E., Lafe, E., Likaj, E., Agalliu, F., & Demiraj, S. (1985). *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Morfologjia). Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës.*

MUSAI, B. (1996). *Mjeshtritë themelore të mësimdhënies. Prishtinë. Shtypshkronja "EURORILINDJA".*

Musai, B. (1999). *PSIKOLOGJI EDUKIMI zhvillimi, të nxëniet, mësimdhënia. Tiranë.*

MUSAI, B. (1999). *Psikologji Edukimi zhvillimi, të nxëniet, mësimdhënia. Tiranë.*

MUSAI, B. (2005). *Mësimdhënia dhe të nxëniet ndërveprues - Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve. Tiranë: Shkencat shoqërore.*

MUSAI, B. (2005). *Mësimdhënia dhe të nxëniet ndërveprues-Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve. Tiranë. Shkencat shoqërore, 11-39.*

Musai, D. B. (1996). *Mjeshtritë themelore të mësimdhënies. Tiranë: Shtypshkronja "Eurolindja".*

OCDE. (2020). *Një kornizë e Guidës së Reagimit të Arsimit ndaj Pandemisë Covid-19 të vitit 2020. Organizata për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik.*

Demiraj, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe (Dispensë e botuar nga UT më 1967; ribotuar nga Universiteti i Prishtinës më 1970) fq.156-170*

Cabej, (1962). "Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe", *BUSHT, SSSHSH gjermanisht fq. 55-67*

YOKUS, G. (2020). *Intergrating outdoor school learning into formal curriculum: designing outdoor learning experiences and developing outdoor learning framework for pre-service teachers. fq.56-59*

Zylfiu, p. (2011). *Teoria e mësimit dhe proceset didaktike të mësimit në Prishtinë. fq.44-56*

Cheng, H.-F., & Zoltan Dornyei. (22 Dec 2008). *The use of Motivational Strategies in Language Instruction: The case of EFL teaching in Taiwan. 153-174.*

Gixhari, Aurora (2016). (Tiranë). *Metodat efektive të komunikimit në mësimit (Monografi).*

Qendra për Arsim Demokratik (2008). *Mësimit dhe të nxënësve ndërvësues: Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve. Tiranë*

Matthews, B., & Ross, L. (2010). *Research Methods, A partial guide for the social sciences.*

Musai, B. (1999). *PSIKOLOGJI EDUKIMI zhvillimi, të nxënësve, mësimit. Tiranë.*

MUSAI, B. (2005). *Mësimit dhe të nxënësve ndërvësues - Modele për zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve. Tiranë: Shkencat shoqërore.*

Musai, D. B. (1996). *Mjeshtritë themelore të mësimit. Tiranë: Shtypshkronja "Eurolindja".*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2011). *Katalogu i programeve të akredituara për zhvillimin profesional të mësimit dhe të udhëheqësve të arsimit. Prishtinë*

Nushi, P. (1995). *Psikologjia e përgjithshme: Kapitla të zgjedhura. Prishtinë*

Salihu, L., Zabeli, N., Hoti, D. (2006). *Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimit. Prishtinë: Qendra për arsim e Kosovës*

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”



FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES SË GJUHËS DHE LETËRSISË SHQIPE

Pyetësorë për mësimdhënës

Përshkrim: Ky pyetësor është bërë për qëllime të hulumtimit për tezë masteri nga studentja: **Elona Bytyqi**, studente në Fakultetin e Edukimit, Drejtimi: “Master i mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqipe”. Pyetësori do të përdoret për vlerësim të shkallës së përdorimit të metodave efektive nga mësimdhënësit e Gjuhës dhe letërsisë shqipe të shkollave të mesme të ulta të komunës së Ferizajt.

Pyetësi do të jetë konfidencial, qasje në të do të kenë vetëm hulumtuesi (Studentja) dhe mësimdhënësi mentor. Ju keni të drejtë të tërhiqeni në ç’do kohë nga hulumtimi.

Ju faleminderit për bashkëpunim!

Udhëzim: Plotësoni pyetësin duke rrethuar përgjigjen më të përshtatshme për ju!

Shkolla: _____

Gjinia:

- a) Femër
- b) Mashkull

Shkolla ku jepni mësim:

- a) Urbane
- b) Rurale

Mosha juaj:

- a) 20-30
- b) 31-40
- c) 41-50
- d) 51-65

1. Përgatitja juaj profesionale:

- a) Bachelor i Gjuhës shqipe 240 ECTS
- b) Bachelor i Gjuhës dhe letërsisë shqipe 240 ECTS
- c) Master i mësimdhënies së Gjuhës dhe letërsisë shqipe 300 ECTS
- d) Master i Gjuhës shqipe 300 ECTS

e) Tjetër _____

2. **Sa vite keni përvojë si mësimdhënës?**

- a) Nën 5 vjet
- b) 6-10 vjet
- c) 11-15 vjet
- d) 16- 20 vjet
- e) Mbi 20 vjet

3. **Sa është numri i nxënësve në klasën tuaj?**

- a) 10-20
- b) 21-30
- c) 31-40
- d) >40

4. **A përdorni metoda efektive në mësimdhënien tuaj?**

- a) Po
- b) Jo

(Nëse përgjigjja juaj është po, vazhdoni me nënpyetjet në vazhdim)

a) **Sa orë mësimore vjetore ja kushtoni përdorimit të metodave efektive?**

- a) 1-5
- b) 6-10
- c) 11-15
- d) 16-20
- e) >20

b) **Si e bëni planifikimin e një ore mësimore me metoda efektive?**

- a) Vetë planifikoni
- b) E merrni të gatshme nga DKA
- c) Planifikoni në bashkëpunim me kolegë
- d) E merrni nga interneti

c) **Sa është i vështirë planifikimi i orëve mësimore me metoda efektive?**

Jashtzakonisht shumë	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak

d) **A vëreni ndonjë ndryshim pozitiv në të mbajturit mend të koncepteve nga nxënësit kur përdorni metoda efektive në klasë?**

- a) Po shumë
- b) Pak

c) Jo fare

5. **Cka ju nxitë të mbani orë me metoda efektive?**

- a) Interesimi dhe entuziazmi i nxënësve
- b) Ndrimi i monotonisë së klasës
- c) Forma e mësimi më interesante dhe atraktive

6. **Sa mendoni që përdorimi i metodave efektive është i rëndësishme në zhvillimin personal dhe akademik të nxënësit?**

Jashtzakonisht shumë	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak

7. **A mendoni që përdorimi i këtyre metodave është pjesë e rëndësishme e mësimdhënies?**

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk kam mendim

8. **A mendoni që mbajtja e orëve mësimore me metoda efektive duhet të jenë obligative me kurrikulë**

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk kam mendim

9. **A ofron kurrikula e Kosovës udhëzime për zhvillimin e orëve mësimore me metoda efektive?**

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

10. **A mendoni që orët mësimore me metoda efektive do duhej të financoheshin nga DKA/Ministria e arsimit?**

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta
- d) Nuk kam mendim

11. **Sa e preferoni si pjesë të mësimdhënies tuaj përdorimin e metodave efektive?**

Jashtzakonisht shumë	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak

--	--	--	--	--

12. Cilat janë përfitimet e mësimdhënies me metoda efektive në krahasim me mësimdhënien tradicionale në klasa? (rrumbullakso 3 opsione më të përshtatshme për ju)

- Rrit interesimin e nxënësve për mësim
- E bënë orën mësimore atraktive
- Zhvillon aftësitë për jetë
- Lidhë jetën e shkollës, me jetën jashtë shkolle
- Ofronë mundësi të mira të punës në grupe të nxënësve
- Zhvillon aftësitë kognitive, afektive dhe motorike të nxënësve
- Nxitë të menduarit kritik dhe kreativ të nxënësve

13. Sa mendoni që ka ndikuar pandemia në zhvillimin e orëve mësimore?

Jashtzakonisht shumë	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak

14. Sa e përdorni teknologjinë gjatë orës mësimore?

Jashtzakonisht shumë	Shumë	Mesatarisht	Pak	Aspak

15. Cila arsye mendoni që është pengesë në përdorimin e metodave efektive në mësimdhënie?

- Vështirsia në menaxhimin e orës
- Kostoja e mjeteve teknologjike
- Klasat e mëdha
- Oraret e ngjeshura/ kurrikula
- Mungesa e projektorëve dhe mjeteve të tjera

16. Sa trajnime keni ndjekur specifikisht për përdorimin e metodave efektive gjatë punës suaj? (jo trajnime tjera vetëm specifike për metoda)

- 0
- 1-3
- 4-6
- >10

17. Nëse do mbaheshin trajnime për organizimin e orëve me metoda efektive a do të merrnit pjesë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndoshta
- d) Nuk e di

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj!